



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.19

2005

26 mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9347 datë 24.2.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe të pellgut të tij ujëmbledhës”.....	701
Ligj nr.9348 datë 24.2.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile”.....	706
Ligj nr.9349 datë 3.3.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillim Ekonomik Arab për projektin e rehabilitimit të ujitjes (Faza III)”.....	714
Ligj nr.9350 datë 3.3.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe të protokollit të saj”.....	728

Ligj nr.9351 datë 3.3.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në emër të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, për parandalimin e evazionit fiskal”.....	738
Ligj nr.9352 datë 3.3.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura".....	751
Ligj nr.9353 datë 3.3.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë"	753
Urdhër i MB nr.108, datë 4.3.2004	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP Shijak)	756

LIGJ
Nr. 9347, datë 24.2.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË LIQENIT TË OHRIT DHE TË PELLGUT TË TIJ UJËMBLEDHËS”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe të pellgut të tij ujëmbledhës”, nënshkruar në Shkup më 17.6.2004.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4502, datë 10.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË LIQENIT TË OHRIT DHE PELLGUT TË TIJ UJËMBLEDHËS

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, këtu e më poshtë të quajtura Palë:

duke pasur parasysh rëndësinë lokale, rajonale dhe globale të liqenit të Ohrit si një zonë me vlera të jashtëzakonshme mjedisore, ekonomike, shkencore, estetike dhe kulturore,

të bindur se një marrëveshje ndërkombëtare është thelbësore për ruajtjen e këtyre vlerave për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, nëpërmjet një mënyre menaxhimi që u lejon Palëve të mbrojnë dhe ruajnë liqenin e Ohrit dhe pellgun e tij ujëmbledhës, duke mundësuar në të njëjtën kohë zhvillimin e qëndrueshëm të pellgut ujëmbledhës,

të ndërgjegjshëm për nevojën e përqaqjes së integruar të mbrojtjes së cilësisë së ujit dhe ruajtjes së integritetit të ekosistemeve tokësore dhe ujore të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit,

duke njohur detyrimet përkatëse në veçanti ndaj Konventës për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore, Konventës së OKB-së për diversitetin biologjik, Konventës për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate ujore (Konventa e Ramsar-it), Konventës për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar (Konventa e Espoo-s), Konventës për akses në informacion, për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe akses në drejtësi për çështjet mjedisore (Konventa e Aarhus-it), Konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe habitatet e tyre (Konventa e Bernës) dhe Konventës për ruajtjen e specieve migratore (Konventa e Bonn-it).

duke pasur parasysh memorandumimin e mirëkuptimit midis Qeverisë shqiptare dhe Qeverisë maqedonase të nënshkruar më 29 nëntor 1996 “Për projektin e ruajtjes së liqenit të Ohrit” dhe memorandumimin e mirëkuptimit të nënshkruar më 7 shtator 2000 “Për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm midis Ministrisë Maqedonase të Mjedisit dhe Planifikimit Fizik dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të Shqipërisë,

duke synuar të thellojnë më tej bashkëpunimin në mbrojtje të liqenit të Ohrit e të pellgut të tij ujëmbledhës, mbështetur edhe në përvojën e fituar nëpërmjet ndërtimit të sistemit të kolektorit dhe facilitetave të tjera shoqëruese gjatë zbatimit të projektit për mbrojtjen e liqenit të Ohrit,

biën dakord si vijon:

Neni 1

Objektivat bazë

Individualisht dhe në bashkëpunim, Palët do të punojnë që:

1. për liqenin e Ohrit dhe pellgun e tij ujëmbledhës, të sigurohet mbrojtje e njëjtë, e integruar dhe zhvillimi i qëndrueshëm sipas normave dhe standardeve të Bashkimit Europian;
2. gjithë liqeni dhe pellgu i tij ujëmbledhës të marrë statusin e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore, si dhe statusin “Rezervë e biosferës” të UNESCO-s;
3. të përgatisin kushtet për miratimin e propozimit të Këshillit të Europës që zona e Ohër-Prepë të caktohet si një nga dy eurorajonet e vetme të Europës Juglindore.

Neni 2

Përkufizime

Për efekt të kësaj Marrëveshjeje:

1. “Pellgu ujëmbledhës i liqenit të Ohrit” i referohet atyre zonave rrethuese ujëmbledhëse, përfshirë edhe liqenin e Prepës, të cilat gjenden brenda kufijve territorialë të Palëve të kësaj Marrëveshjeje.

2. “Organizma dypalëshe” i referohet atyre organizmave dypalëshe (nga të dyja Palët) të krijuara si pjesë të projektit të ruajtjes së liqenit të Ohrit dhe përfshin task-forcën e monitorimit të liqenit të Ohrit, Komitetin e Menaxhimit të Pellgut Ujëmbledhës, Komitetin e Peshkimit, si dhe Komitetin e Koordinimit të Parkut të Prepës, si dhe çdo organizëm tjetër të krijuar nga Palët që merret me përdorimin e tokës ose me funksione, ose me përgjegjësi të menaxhimit mjedisor në pellgun ujëmbledhës të liqenit të Ohrit.

Neni 3

Detyrime të përgjithshme

1. Për arritjen e synimeve të nenit 1, Palët do të marrin masat e nevojshme, individualisht ose në bashkëpunim:

- a) për të parandaluar, kontrolluar dhe pakësuar ndotjen e ujërave në pellgun ujëmbledhës;
- b) për të mbrojtur tokën nga erozioni, varfërimi, infeksionet dhe ndotjet;
- c) për të ruajtur biodiversitetin, duke mbrojtur sidomos speciet endemike, të rralla, të kërcënuara apo të rrezikuara të florës dhe faunës;
- d) për të parandaluar futjen dhe riprodhimin e specieve, bimëve dhe kafshëve joautoktone;
- e) për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të pellgut ujëmbledhës;
- f) për të shmangur çdo dëmtim serioz të vlerave kulturore dhe peizazheve natyrore;
- g) për të parandaluar dhe kontrolluar veprimtaritë ekonomike, të cilat shkaktojnë ose mund të shkaktojnë pasoja negative në pellgun ujëmbledhës të liqenit.

2. Për këtë qëllim, secila nga Palët:

a) do të realizojë harmonizimin e kritereve dhe standardeve, të strategjive dhe rregulloreve në përgatitjen e planeve të zhvillimit urban, të rregullimit të territorit dhe në planet e përdorimit të tokës bujqësore, për të siguruar administrimin e tokës së pellgut ujëmbledhës sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

b) do të miratojë dhe zbatojë me rigorozitet standardet dhe kriteret mjedisore të pellgut ujëmbledhës të përshkruara në nenin 4;

c) do të shpejtojë realizimin e plotë dhe efektiv të të drejtave të çdo individit të komunitetit të pellgut ujëmbledhës për informacion mjedisor, për pjesëmarrjen publike në vendimmarrje për çështje të mjedisit dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështje të mjedisit;

d) do të vendosë dhe përdorë një sistem efektiv monitorimi për të mbajtur nën kontroll gjendjen dhe cilësinë e liqenit dhe të pellgut ujëmbledhës.

Neni 4

Standardet dhe kriteret mjedisore të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit

1. Palët e kësaj Marrëveshjeje, me ndihmën e Komitetit, siç është përshkruar në nenin 5, do të vendosin kritere, standarde, kufij dhe objektiva të sakta për mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit në mënyrë që të arrijnë objektivat bazë të nenit 1.

2. Për këtë qëllim, ato do të hartojnë dokumente teknike të veçanta, të cilat:

a) zbatojnë angazhimet ligjore për aplikimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare dhe atyre të Bashkimit Europian për mbrojtjen dhe ruajtjen e liqenit dhe të pellgut ujëmbledhës;

b) përshtatin standardet dhe kriteret mjedisore kombëtare me kushtet dhe kërkesat lokale të pellgut ujëmbledhës;

c) kërkojnë përdorimin e teknologjive më të mira të disponueshme dhe praktika mjedisore bashkëkohore.

Neni 5

Komiteti i menaxhimit të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit

1. Në mënyrë që të sigurohet me efektivitet në arritjen e synimeve dhe angazhimeve të specifikuar në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord të krijojnë Komitetin e liqenit dhe pellgut të tij ujëmbledhës;

2. Si organizëm dypalësh, Komiteti:

- monitoron ecurinë e veprimtarive për mbrojtjen e liqenit dhe të pellgut të tij ujëmbledhës;

- u sugjeron Palëve masa e veprime të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes, i fton ato në bashkëpunime, koordinime e projekte të përbashkëta;

- evidenton veprime e qëndrime të tyre, që bien ndesh me këtë Marrëveshje.

3. Komiteti do të përbëhet nga një numër i barabartë anëtarësh nga secila Palë. Komiteti do të përfshijë tre titullarë të organeve shtetërore qendrore të emëruar nga qeveritë përkatëse, tre titullarë të qeverisjeve vendore dhe një përfaqësues i shoqërisë civile. Në përbërje të tij do të ketë një përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar të donatorëve, pa të drejtë vote.

4. Në varësi të tematikës së takimit, Komiteti fton ekspertë të fushave përkatëse në takimet e tij.

5. Komiteti mblidhet në mbledhje të zakonshme një herë në gjashtë muaj. Një mbledhje e tij e jashtëzakonshme mund të thirret me kërkesën e shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. Mbledhjet zhvillohen një herë në Shqipëri dhe një herë në Maqedoni.

6. Në mbledhjen e tij të parë Komiteti cakton kryetarin e sekretarin, miraton rregulloren e brendshme të organizimit e të funksionimit të tij, si dhe të sekretariatit në vartësi të tij. Një kopje e këtyre rregulloreve u jepet Palëve. Kryetari dhe sekretari kanë mandat njëvjeçar dhe me rotacion të Palëve.

7. Komiteti do të shërbejë në kapacitetin e një organizmi dypalësh, i cili do të mbajë lidhje me donatorët në mënyrë për të përfituar projekte dhe donacione të cilat do të përdoren për implementimin e kësaj Marrëveshjeje.

8. Komiteti harton dhe publikon raportin vjetor të gjendjes së mjedisit për zonën e pellgut ujëmbledhës, në të cilin ka një rubrikë ku pasqyrohet puna e tij.

9. Komiteti do të formohet brenda tre muajsh nga shkëmbimi i instrumentit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet dy Palëve.

Neni 6

Funksione specifike të Komitetit

Komiteti ndihmon Palët për:

a) hartimin dhe zbatimin e standardeve, kriterëve mjedisore dhe kërkesave të zhvillimit të qëndrueshëm në bazë të të cilave realizohet mbrojtja e integruar e liqenit dhe e pellgut të tij ujëmbledhës, si dhe mbrojtja e veçantë e tokës, ujit, ajrit, burimeve natyrore, diversitetit biologjik, mjedisëve urbane, peizazheve natyrore dhe vlerave kulturore;

b) plotësimin e kuadrit ligjor rregullator për zonën e pellgut ujëmbledhës;

c) hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit që do të zbatohen në liqen e në pellgun ujëmbledhës;

d) hartimin e programit dhe zbatimin e sistemeve të efektshme të monitorimit për të mbajtur nën kontroll gjendjen e mjedisit dhe cilësinë e liqenit e të pellgut ujëmbledhës;

e) grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e informacionit mjedisor mbi liqenin e Ohrit dhe pellgun e tij ujëmbledhës;

f) përgatitjen e aktiviteteve për krijimin e kushteve për caktimin e zonës Prespë-Ohër si një nga dy zonat e vetme eurorajone në Europën Juglindore;

g) rritjen e pjesëmarrjes së publikut, të OJF-ve dhe të faktorëve të tjerë në mbrojtje të liqenit e të pellgut ujëmbledhës.

2. Komiteti i jep rekomandime dhe opinione secilës Palë mbi bazën e marrjes së opinionit paraprak nga nënkomitetet e përbashkëta për zonat specifike për të zbatuar kërkesat e kësaj Marrëveshjeje dhe për të forcuar efikasitetin kundrejt:

i) planeve territoriale të pjesës përkatëse të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit;

ii) statusit të masave legjislative dhe rregullatore të lidhura me pellgun ujëmbledhës të liqenit të Ohrit;

iii) programeve përkatëse të zhvillimit, politikave dhe vendimeve të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, të cilat prekin ose mund të prekin qëllimet dhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Komiteti grumbullon çdo informacion ekzistues që lidhet me liqenin dhe pellgun ujëmbledhës, kërkon dhe merr propozime nga organet shtetërore, nga organizmat dypalëshe dhe nga OJF-të për të përmirësuar punën e tij dhe për të rritur angazhimet e Palëve për zbatimin e Marrëveshjes.

Neni 7

Vendimet e Komitetit

1. Komiteti i merr vendimet me konsensus. Në rast se konsensusi nuk arrihet, Palët do t'ia referojnë çështjen për zgjidhje qeverive respektive.

2. Komiteti ua dërgon vendimet e tij Palëve në formën e rekomandimeve duke përcaktuar edhe kohën e zbatimit.

3. Çdo Palë zbaton vendimet e Komitetit në përputhje me ligjet kombëtare dhe i raporton rregullisht Komitetit për masat që ka marrë për zbatimin e tij.

4. Kur një Palë nuk është në gjendje ose është pjesërisht në gjendje të zbatojë vendimin, njofton Komitetin duke dhënë arsyet e moszbatimit dhe propozon mënyrat dhe kohën e zbatimit.

5. Komiteti mban regjistrin e vendimeve që ka miratuar.

Neni 8
Sekretariati i Komitetit

1. Në kryerjen e detyrave të tij, Komiteti ndihmohet nga sekretariati.
2. Sekretariati është organizëm teknik në varësi të Komitetit, që vepron në emër dhe për llogari të tij. Ai ka për detyrë:
 - a) të përgatisë mbledhjet e Komitetit;
 - b) të hartojë dhe administrojë dokumentacionin ku pasqyrohet veprimtaria e Komitetit dhe e vetë sekretariatit;
 - c) të hartojë, shpërndajë dhe ndjekë zbatimin e vendimeve të Komitetit;
 - d) të grumbullojë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionet;
 - e) të përgatisë studime, analiza dhe projekte;
 - f) të publikojë dhe shpërndajë materialet e mbledhjeve;
 - g) të realizojë lidhjet e Komitetit me organet qendrore dhe vendore të Palëve, me organizmat dypalëshe, me institucionet kërkimore-shkencore të Palëve, me OJF-të, me donatorët dhe me organizma mjedisore ndërkombëtare;
 - h) të mbajë dokumentacionin ekonomik-financiar;
 - i) të kryejë veprimtari sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese;
 - j) të kryejë detyrat që përcaktohen në rregulloren e tij të brendshme, si dhe detyra të tjera që i ngarkon Komiteti sipas rastit.
3. Përgjegjësi i sekretariatit është sekretari i Komitetit.
4. Sekretariati paraqet raportin e punës së tij për periudhën midis dy mbledhjeve e në çdo mbledhje të Komitetit.
5. Sekretariati përbëhet nga të paktën 1 ekspert prej secilës prej Palëve.
6. Sekretariati vendoset në qytetin e Ohrit.
7. Shpenzimet për selinë ku vendoset dhe mirëmbajtjen e saj përballohen nga Pala maqedonase.
8. Pajisjet dhe çdo mjet ose e mirë tjetër teknike e nevojshme për kushte të përshtatshme për fillimin e punës së sekretariatit përballohen nga Pala maqedonase.
9. Çdo Palë përballon koston financiare të përfaqësuesve të vet që ka caktuar si anëtarë të sekretariatit.
10. Secila Palë është e detyruar të përcaktojë një buxhet për mbulimin e shpenzimeve të përbashkëta që dalin nga puna e rregullt e sekretariatit.

Neni 9
Shpenzimet

1. Çdo Palë do të përballojë shpenzimet e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të saj në mbledhjet e Komitetit.
2. Pala në territorin e së cilës zhvillohet takimi i Komitetit përballon shpenzimet e mbledhjes.

Neni 10
Ndryshimet në këtë Marrëveshje

1. Secila Palë mund të propozojë ndryshime në këtë Marrëveshje.
2. Propozimet për ndryshime do të shqyrtohen në mbledhjen vjetore të Komitetit ose në një mbledhje të jashtëzakonshme të tij, e thirrur enkas për këtë qëllim.
3. Një ndryshim i Marrëveshjes së tanishme do të hyjë në fuqi për Palët pas shkëmbimit të instrumenteve të tyre të pranimit të ndryshimit.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rastin e një mosmarrëveshjeje midis Palëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të kërkojnë një zgjidhje nëpërmjet negocimit apo çdo mjeti tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që është e pranueshme për to.

2. Kur Palët nuk arrijnë një zgjidhje në përputhje me pikën 1 të këtij neni, mosmarrëveshja do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 12

Hyrja në fuqi dhe pranimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë hyrjen në fuqi të ligjit që ratifikon këtë Marrëveshje.

Neni 13

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një kohë të pakufizuar derisa njëra nga Palët, nëpërmjet kanaleve diplomatike, do të njoftojë dëshirën e saj për ta ndërprerë atë. Në këtë rast, Marrëveshja do të përfundojë gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi të shkruar. Përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe, ky përfundim nuk do të prekë vlefshmërinë e çdo marrëveshjeje apo projekti të arritur në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

Teksti autentik

Kjo Marrëveshje është hartuar në anglisht, shqip dhe maqedonisht. Në rastin e ndryshimeve ndërmjet teksteve, versioni anglisht do të merret si autentik.

Nënshkruarit e mëposhtëm të pranishëm, me autorizimin e duhur për të nënshkruar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Shkup më 17.6.2004.

LIGJ

Nr.9348, datë 24.2.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË BULLGARISË PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJET CIVILE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4503, datë 10.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJET CIVILE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË BULLGARISË

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Bullgarisë, të cilat këtu quhen “Palët Kontraktuese”,

me dëshirën për të vendosur një bashkëpunim më të ngushtë në fushën e marrëdhënieve juridike dhe duke pasur respekt reciprok për sovranitetin e tyre, kanë vendosur t’i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Mbrojtja ligjore

1. Shtetasit e çdo Pale Kontraktuese gëzojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të njëjtën mbrojtje ligjore të të drejtave të tyre personale dhe pasurore, si edhe shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese. Ata kanë të drejtë t’i drejtohen gjykatës, autoriteteve të tjera, prokurorisë dhe çdo institucioni tjetër kompetent për çështjet civile dhe mund të ngrënë pretendime ose padi, si dhe të kryejnë akte të tjera procedurale në të njëjtat kushte, si edhe shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Dispozita e paragrafit 1 zbatohet për personat juridikë të krijuar në territorin e njëres prej Palëve Kontraktuese në pajtim me legjislacionin e saj.

3. Termi “çështje civile” ka kuptimin e të gjitha çështjeve që nuk përfshihen në fushën penale dhe në fushën administrative.

Neni 2 Ndihma e ndërsjellë

Autoritetet dhe institucionet e Palëve Kontraktuese, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje, japin ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile brenda kompetencës së tyre, sipas përcaktimit të legjislacionit të brendshëm të secilës prej Palëve.

Neni 3 Ndihma ligjore falas dhe përjashtimi nga shpenzimet

1. Shtetasit e çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtën të marrin ndihmë ligjore falas në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në të njëjtën mënyrë si edhe shtetasit e vet, në pajtim me legjislacionin përkatës të Palës Kontraktuese, kur kërkohet ndihmë juridike falas.

2. Shtetasit e çdo Pale Kontraktuese, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përjashtohen nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore në të njëjtat kushte dhe sasira si edhe shtetasit e vet.

Neni 4

Procedura e përjashtimit nga shpenzimet

1. Përjashtimi nga shpenzimet sipas nenit 3 të Konventës realizohet nëpërmjet një vendimi gjykate në vendin e kërkuar me kërkesë të personit të interesuar. Ky përjashtim rregullohet në pajtim me legjislacionin e vendit të kërkuar.

2. Nëse personi sipas paragrafit 1 është me vendbanim të zakonshëm te një palë e tretë, dokumentet e nevojshme për përjashtimin nga shpenzimet mund të lëshohet nga agjencia diplomatike ose konsullore e Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës është personi.

3. Gjykata e Palës së Kërkuar që është kompetente për dhënien e vendimit mbi përjashtimin nga shpenzimet mund të kërkojë informacion shtesë.

Neni 5

Heqja e shpenzimeve gjyqësore

1. Heqja e shpenzimeve gjyqësore nuk mund të kërkohet nga një shtetas i një vendi kontraktues që shfaqet në gjykatën e një vendi tjetër kontraktues si paditës ose i paditur, thjesht për faktin e qenies së tij si shtetas i huaj ose të mungesës së qëndrimit të përhershëm në këtë vend.

2. Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni zbatohet edhe për personat juridikë.

Neni 6

Llojet e ndihmës ligjore

Me kërkesë, Palët Kontraktuese i japin njëra-tjetrës dokumente gjyqësore dhe jogjyqësore, marrin masa për sigurimin e pretendimeve, marrin prova nga pjesëmarrësit në gjykim, dëshmitarët dhe ekspertët, ndërmarrin ekzaminime dhe inspektime, njohin dhe ekzekutojnë vendime, duke përfshirë zbatimin e masave për gjetjen e debitorit dhe masa të tjera procedurale.

Neni 7

Mjetet e komunikimit

1. Organet kompetente të Palëve Kontraktuese komunikojnë nëpërmjet organeve qendrore të përcaktuara në këtë Marrëveshje për dhënien e ndihmës së ndërsjellë.

2. Organet qendrore të përmendura në paragrafin 1 janë për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë dhe për Republikën e Bullgarisë, Ministria e Drejtësisë.

Neni 8

Gjuha

Organet qendrore të Palëve Kontraktuese përdorin gjuhën e tyre ose gjuhën angleze në lidhje me të gjitha çështjet e kësaj Konvente.

Neni 9

Forma e dokumenteve

Dokumentet dërguar organeve kompetente të Palëve Kontraktuese për qëllimin e dhënies së ndihmës së ndërsjellë të përpiluar në gjuhën zyrtare të palës dërguese, shoqërohen me një përkthim të vërtetuar në gjuhën e palës kontraktuese pritëse ose në anglisht.

Neni 10
Shpenzimet e ndihmës së ndërsjellë

Palët Kontraktuese i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë juridike falas, përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë Marrëveshje.

Neni 11
Refuzimi i ndihmës së ndërsjellë

Kur pala pritëse mendon se ndihma e ndërsjellë, nëse jepet, mund të cenojë sovranitetin, sigurinë dhe rendin e saj shoqëror ose që mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm, ajo mund të refuzojë dhënien e ndihmës së ndërsjellë dhe informon palën kërkuese për arsyet e refuzimit.

KAPITULLI 2
NJOFTIMI DHE DËRGIMI I DOKUMENTEVE

Neni 12
Kërkesa për njoftimin ose dërgimin e dokumenteve

1. Nëse dokumentet gjyqësore ose jogjyqësore u referohen personave që kanë vendqëndrimin ose vendbanimin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, organet kompetente të palës kërkuese i drejtohen organit qendror të palës pritëse me një kërkesë për njoftimin ose dërgimin e dokumenteve.

2. Dokumentet në gjuhën e palës kërkuese, e shoqëruar nga një përkthim në gjuhën e palës pritëse ose në anglisht, i bashkëngjiten kërkesës.

Neni 13
Dërgimi i dokumenteve

1. Organi qendror i palës pritëse i dërgon dokumentet ose merr masa për dërgimin e tyre në një mënyrë që e konsideron më të përshtatshme.

2. Dërgimi ose përpjekja për dërgimin vërtetohet nëpërmjet përpilimit të një fature ose regjistri, i cili i kthehet organit qendror të palës kërkuese së bashku me një kopje të dokumenteve. Dokumenti që vërteton zbatimin e kërkesës për të dërguar dokumentet përmban datën e dërgimit, nënshkrimin e marrësit dhe nënshkrimin e personit që kryen kërkesën. Nëse marrësi refuzon të marrë dokumentet, përfshihen dhe arsyet e refuzimit të tij.

3. Këto shërbime që i bëhen palës pritëse nuk janë shkak për pagesën e ndonjë tarife apo për shpenzime.

Neni 14
Dërgimi i dokumenteve nëpërmjet agjentëve diplomatikë ose konsullorë

Me kërkesën e organeve kompetente agjentët diplomatikë ose konsullorë të njëjës prej Palëve Kontraktuese të akredituar te Pala tjetër Kontraktuese mund t'u dërgojnë dokumente gjyqësore ose jogjyqësore shtetasve të tyre. Këto veprime nuk mund të përmbledhin masat e detyrimit dhe nuk mund të jenë në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të shtetit të vendbanimit.

Neni 15
Ligji i zbatuar për ndihmën e ndërsjellë

1. Kur ofrohet ndihma e ndërsjellë, organi pritës zbaton legjislacionin e brendshëm.

2. Kur jepet ndihmë e ndërsjellë, organi pritës, me kërkesë të palës dërguese, mund të zbatojë procedurën e Palës tjetër Kontraktuese, përveç kur ajo është në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të Palës Kontraktuese pritëse.

KAPITULLI 3 LETËR POROSITË

Neni 16

Forma e kërkesës/letërporositë për ndihmë të ndërsjellë

1. Kërkesa/letërporosia për ndihmë të ndërsjellë bëhet me shkrim dhe përmban, në lidhje me tipin e kërkesës, të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e organit kërkues;
b) emrin e organit pritës, nëse është e mundur;
c) natyrën dhe përmbajtjen e çështjes për të cilën kërkohet ndihma ligjore, të dhënat e veçanta të kërkesës;

d) emrat, mbiemrat, emri i nënës, emri i babait të personave që kanë të bëjnë me çështjen, shtetësinë, seksin, profesionin, vendqëndrimin ose vendbanimin, datën dhe vendbanimin, emrin dhe vendin e krijimit të personit juridik;

e) emrat dhe adresat e përfaqësuesve të personave të përmendur në nënparagrafin “d”;

f) titullin e dokumentit i cili duhet të dërgohet.

2. Kërkesa për ndihmë të ndërsjellë duhet të nënshkruhet dhe të vuloset nga organi kompetent i vendit pritës.

Neni 17

Kryerja e kërkesës

1. Dokumenti që tregon kryerjen e kërkesës për dërgimin e dokumenteve përmban datën e dorëzimit, nënshkrimin e marrësit dhe nënshkrimin e personit që kryen kërkesën. Nëse pritësi refuzon marrjen e dokumentit, tregohen edhe shkaqet për refuzimin e bërë.

2. Kur në pajtim me legjislacionin e Palës Kontraktuese pritëse kryerja e kërkesës nuk është në kompetencën e gjykatës ose të organeve të tjera të asaj pale, kërkesa mund të kthehet duke treguar shkaqet e refuzimit.

3. Kur organi pritës i Palës Kontraktuese nuk është kompetent për përmbushjen e kërkesës, ai ua kalon atë organeve kompetente të kësaj Pale Kontraktuese për ta përmbushur dhe informon organin dërgues të Palës tjetër Kontraktuese. Pala tjetër mbahet e informuar për sa më sipër.

4. Organi gjyqësor dërgues mund të kërkojë që palët e interesuara dhe, kur është e mundur, përfaqësuesit e tyre të informohen për datën dhe vendin e zbatimit të masave të kërkuara me qëllim që të ndihmohet ekzekutimi i vendimit.

Neni 18

Metodat e veçanta për përmbushjen e kërkesës

1. Organet kompetente të Palëve Kontraktuese që përmbushin kërkesën për ndihmë të ndërsjellë zbatojnë ligjin e tyre të brendshëm për të përcaktuar metodën që duhet të zbatohet.

2. Ata mund të përmbushin kërkesën e organit kërkues në lidhje me zbatimin e një metode të caktuar, me kusht që ajo të mos jetë në mospërputhje me ligjin e palës pritëse.

3. Pala pritëse ka të drejtë të kërkojë nga pala kërkuese të rimburojë pagesën që u është bërë ekspertëve dhe shpenzimet e shkaktuara nga metoda e veçantë e kërkuar nga pala kërkuese.

4. Secila Palë Kontraktuese është e lirë të zbatojë, nëpërmjet agjencive të tyre diplomatike ose konsullore, kërkesat gjyqësore në lidhje me shtetasit e saj, pa zbatuar masat e detyrueshme.

KAPITULLI 4
NJOHJA DHE ZBATIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

Neni 19

Vendimet që njihen dhe ekzekutohen

1. Në pajtim me këtë Marrëveshje, Palët Kontraktuese njohin dhe zbatojnë në territorin e tyre vendimet gjyqësore që janë dhënë dhe kanë hyrë në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Termi “vendim gjyqësor” për të dyja Palët ka kuptimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar ose të ndërmjetëm dhe të një vendimi penal që ka të bëjë me një pretendim civil.

Neni 20

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

1. Kërkesa për njohje dhe ekzekutim të një vendimi gjyqësor depozitohet që e ka dhënë vendimin dhe që ia transmeton kërkesën gjykatës së Palës tjetër Kontraktuese në mënyrën e parashikuar në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi gjyqësor shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) një kopje e vendimit e vërtetuar nga gjykata. Kur vendimi nuk tregon qartë që ai është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, atëherë lëshohet një dokument tjetër nga gjykata që tregon se vendimi ka hyrë në fuqi;

b) një dokument i lëshuar nga gjykata për ekzekutim të pjesshëm të vendimit në territorin e palës kërkuese, nëse është e nevojshme;

c) një dokument që tregon se Pala që nuk ka marrë pjesë në gjykim, ose kur është i pazot përfaqësuesi i saj, është thirrur në gjykatë rregullisht.

3. Dokumentet e përmendura më sipër shoqërohen nga një përkthim i vërtetuar në gjuhën e Palës Kontraktuese pritëse ose në anglisht, i bërë nga agjencitë diplomatike ose konsullore, apo nga një person tjetër i autorizuar nga njëra prej Palëve.

Neni 21

Procedura e njohjes dhe e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

1. Vendimet gjyqësore njihen dhe ekzekutohen nga gjykata kompetente e Palës Kontraktuese pritëse në pajtim me procedurën e parashikuar nga ligji i brendshëm i asaj Pale Kontraktuese.

2. Gjykata që merr kërkesën, nuk e rishikon vendimin në themel, por vetëm në lidhje me përputhjen e tij me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjykata që merr kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të gjykatës së huaj mund të kërkojë dokumente shtesë nga gjykata që ka dhënë vendimin.

Neni 22

Refuzimi i njohjes dhe i ekzekutimit të vendimit

Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohet në rastet e mëposhtme:

a) vendimi nuk ka hyrë në fuqi ose nuk është i ekzekutueshëm sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese ku ai është dhënë;

b) legjislacioni i brendshëm i Palës që i drejtohet kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin u jep gjykatave të veta juridiksionin ekskluziv;

c) Pala që ka munguar në gjykim ose, në rastin e pazotësisë së plotë ose të pjesshme të saj, përfaqësuesi, nuk është thirrur në gjykatë rregullisht në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palës Kontraktuese prej nga ka ardhur vendimi;

d) gjykata e Palës pritëse ka dhënë për të njëjtat palë dhe për të njëjtën çështje një vendim, i cili ka hyrë në fuqi apo gjykimi është duke u zhvilluar në gjykatë, apo kur është njohur një vendim gjyqësor i dhënë nga një juridiksion i tretë për të njëjtat palë dhe për të njëjtën çështje;

e) vendimi i dhënë nga gjykatat e Palës kërkuese përmban dispozita që janë në mospërputhje me politikën publike të Palës pritëse.

KAPITULLI 5

PËRJASHTIMI NGA LEGALIZIMI, STATUSI CIVIL DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 23

Dokumentet zyrtare

1. Dokumentet zyrtare të lëshuara në territorin e njëjës prej Palëve Kontraktuese përjashtohen nga legalizimi ose çdo formalitet tjetër të ngjashëm kur paraqiten në territorin e Palës tjetër.

2. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje “dokumente zyrtare” janë:

- dokumentet e lëshuara nga gjykatat, prokuroritë ose përmbaruesit;
- dokumentet e lëshuara nga organet administrative;
- dokumentet noteriale;
- certifikata zyrtare, të dhënat nga regjistrat, vërtetimi i datave dhe vërtetimi i nënshkrimeve dhe dokumenteve personale.

Neni 24

Transformimi i dokumenteve në lidhje me statusin civil

1. Secila prej Palëve Kontraktuese i transmeton Palës tjetër, me kërkesë dhe falas, certifikata dhe kopje të vendimeve gjyqësore në lidhje me statusin civil të shtetasve të Palës kërkuese, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm.

2. Kërkesat dërgohen nëpërmjet organeve qendrore. Secila nga Palët Kontraktuese do të jetë e lirë të transferojë nëpërmjet agjencive konsullore kërkesa dhe certifikatat që lidhen me statusin civil.

Neni 25

Shkëmbimi i informacionit

Organet qendrore, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me legjislacionin dhe jurisprudencën në territorin e tyre, si dhe kopjet e vendimeve të gjykatave.

KAPITULLI 6

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Vlefshmëria e dokumenteve

Dokumentet e lëshuara ose të vërtetuara nga gjykatat ose çdo organ tjetër kompetent i njëjës prej Palëve Kontraktuese konsiderohen të vlefshme, kur organi kompetent i ka pajisur me vulë rregullisht. Dokumentet që përputhen me këto kërkesa njihen nga gjykatat dhe nga organet e tjera kompetente të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 27

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nga Palët Kontraktuese nëpërmjet konsultimeve ndërmjet organeve të përmendura në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje ose nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshjeje i nënshtrohet ratifikimit dhe hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas këmbimit të instrumenteve të ratifikimit.

Neni 29

Marrëdhëniet me marrëveshjet ekzistuese

Kjo Marrëveshjeje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet të garantuara nëpërmjet marrëveshjeje ekzistuese të lidhura me shtetet e tjera kontraktuese.

Neni 30

Ndryshimi i Marrëveshjes

1. Palët Kontraktuese konsultohen me njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Ndryshimet e Marrëveshjes hyjnë në fuqi sipas parashikimit të nenit 28.

Neni 31

Denoncimi

Kjo Marrëveshjeje përfundohet për një periudhë kohore të pacaktuar dhe e humb fuqinë pas skadimit të një afati 6-mujor nga marrja prej një Pale të një njoftimi me shkrim për denoncimin nëpërmjet kanalit diplomatik.

Bërë në Sofje, më 17 nëntor 2003 në dy kopje, në shqip, bullgarisht dhe anglisht, të gjitha tekstet janë njëlloj të vlefshme. Në rast mospërputhjeje ndërmjet teksteve, merret për bazë teksti anglisht.

LIGJ

Nr. 9349, datë 3.3.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT KUVAJTIAN PËR ZHVILLIM EKONOMIK ARAB PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË UJITJES (FAZA III)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillim Ekonomik Arab për projektin e rehabilitimit të ujitjes (Faza III)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4504, datë 17.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA E HUASË

PROJEKTI I REHABILITIMIT TË UJITJES (FAZA III) NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT KUVAJTIAN PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

Marrëveshja e datës _____ ndërmjet Republikës së Shqipërisë (e quajtur këtej e tutje Huamarrësi), përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab (i quajtur këtej e tutje Fondi) nga ana tjetër.

Huamarrësi i ka kërkuar Fondit ta ndihmojë në financimin e projektit të rehabilitimit të ujitjes (faza III) të përshkruar në listën 2 të kësaj Marrëveshjeje (i quajtur këtë e tutje projekt);

Huamarrësi ka siguruar nga Shoqëria Ndërkombëtare e Zhvillimit (e quajtur këtej e tutje IDA) një kredi me një shumë ekuivalente me 15 milionë dollarë për të ndihmuar në financimin e projektit;

Huamarrësi ka siguruar nga fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar (i quajtur këtej e tutje OPEC) një kredi me një shumë ekuivalente me 5.7 milionë dollarë për të ndihmuar në financimin e projektit;

Huamarrësi zotohet të financojë koston e vlerësuar të projektit që mbetet e pambuluar në monedhë lokale apo të huaj dhe çdo kosto tjetër që mund të rezultojë;

Qëllimi i Fondit është të ndihmojë vendet arabe dhe vendet e tjera në zhvillim për zhvillimin e ekonomisë së tyre, dhe t'u sigurojë atyre huatë e nevojshme për kryerjen e projekteve e programeve të tyre të zhvillimit; dhe

Fondi e kupton rëndësinë dhe dobishmërinë e projektit në zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit; dhe

Fondi është dakord që sa më sipër, t'i japë një hua Huamarrësit sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje.

Prandaj palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Huaja, interesi dhe detyrimet e tjera, ripagimi, vendi i pagesës

1.01. Fondi është dakord që t'i japë hua Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje, një shumë ekuivalente me katër milionë dinarë kuvajtianë. (K.D. 4 000 000).

1.02. Huamarrësi do të paguajë një interes prej dy për qind (2%) në vit të shumës kryesore të huasë së tërhequr dhe të papaguar. Interesi do të fillojë nga data përkatëse që do tërhiqen shumat.

1.03. Do të paguhet një detyrim shtesë prej zero pikë pesë për qind (11 e 1%) në vit në shumat e tërhequra nga huaja dhe të papaguara, për të përballuar shpenzimet administrative, si dhe shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

1.04. Detyrimi i paguar për angazhimet speciale të futura nga Fondi, me kërkesën e Huamarrësit sipas paragrafit 3.02 të kësaj Marrëveshjeje, do të jetë 0.5% (1/2 e 1%) në vit e shumës kryesore të çdo angazhimi special të papaguar.

1.05. Interesat dhe detyrimet e tjera do të llogariten duke pasur si bazë 360 ditë të vitit dhe 12 muaj (30 ditë) për çdo periudhë më të shkurtër se 6-mujore.

1.06. Huamarrësi do të paguajë pjesën kryesore të huasë sipas neneve të ripagimit të paraqitur në listën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

1.07. Interesat dhe detyrimet e tjera do të paguhen në periudha gjashtëmujore në 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

1.08. Huamarrësi ka të drejtë për pagesat e të gjithë interesit të rrjedhur dhe detyrimeve të tjera, për jo më pak se 45 ditë, të njoftojë Fondin për të paguar me avancë:

a) të gjithë shumën e huasë në kohën e caktuar;

b) të gjithë shumën e një ose më shumë periudhave, me kusht që në datën e kësaj parapagese nuk do të paguhet ndonjë pjesë e huasë pas asaj pjese që parapaguhet.

1.09. Shuma e huasë, interesi, si dhe detyrimet e tjera të saj do të paguhen në Kuvajtit ose në vende të tjera që Fondi do t'i quajë të arsyeshme.

Neni 2

Sigurimi i parasë

2.01. Të gjitha llogaritë e trasaksioneve financiare të zbatuara në këtë Marrëveshje, si dhe të gjitha shumat që hyjnë këtu, do të paguhen në dinarë kuvajtjanë.

2.02. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Fondi do të sigurojë, me kërkesën dhe duke vepruar si agjent për Huamarrësin, aq para sa mund të kërkohen për pagesën e kostos së mallrave për t'u financuar nga huaja, ose për kthimin e një kostoje të tillë në atë monedhë në të cilën ajo kërkohet. Shuma që do të gjykohet për t'u tërhequr nga huaja, do të jetë e barabartë me shumën në dinarë kuvajtjanë të kërkuar për blerjen e shumës përkatëse të valutës.

2.03. Kur ripagesa e shumës kryesore ose pagesa e interesit dhe e detyrimeve të tjera mbi huanë është bërë, Fondi me kërkesën dhe veprimin si një agjent për Huamarrësin, mund të sigurojë shumën e dinarëve kuvajtjanë të kërkuar për një ripagesë të tillë, siç mund të jetë rasti, kundrejt pagesës nga Huamarrësi të shumës së kërkuar për këtë blerje në valutë ose valuta, siç mund të pranohet kohë pas kohe nga Fondi.

Çdo pagesë që do t'i bëhet Fondit dhe që kërkohet në këtë Marrëveshje do të konsiderohet e efektshme vetëm kur dinarët kuvajtjanë janë marrë nga Fondi.

2.04. Kurdo që të jetë e nevojshme për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, për të përcaktuar vlerën e një monedhe në raport me një tjetër, kjo vlerë do të jetë e përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Fondi.

Neni 3

Tërheqja dhe përdorimi i të ardhurave të huasë

3.01. Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga huaja shumat e shpenzuara ose që shpenzohen për projektin në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Me përjashtim të rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, asnjë shumë nuk do të tërhiqet nga huaja për llogari të shpenzimeve të bëra përpara datës 1.10.2004.

3.02. Sipas kërkesës së Huamarrësit dhe sipas afateve dhe kushteve që do të bihet dakord midis Fondit dhe Huamarrësit, Fondi mund të fillojë bisedimet (zotimet) e veçanta me shkrim, për t'i paguar shumat Huamarrësit përsa i përket kostos së mallrave që do të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje duke mos marrë parasysh pezullimet apo anulimet pasuese.

3.03. Kur Huamarrësi do të dojë të tërheqë ndonjë shumë nga huaja ose t'i kërkojë Fondit të fillojë bisedimet e veçanta sipas paragrafit 3.02, Huamarrësi do t'i dërgojë Fondit një kërkesë me shkrim në një formë të tillë, duke përmbytur ato deklarata, marrëveshje e dokumente të tjera që Fondi do t'i quajë të arsyeshme.

Kërkesat për tërheqje me dokumentacionin e nevojshëm, siç thuhet në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Fondi do të bien dakord ndryshe, do të bëhen menjëherë në lidhje me shpenzimet për projektin.

3.04. Huamarrësi do ta pajisë Fondin me dokumentet dhe evidencat në mbështetje të kërkesës për tërheqje, siç do t'i kërkojë Fondi, në qoftë se Fondi më parë ose më pas do të ketë lejuar ndonjë tërheqje të kërkuar në lutje.

3.05. Çdo kërkesë për tërheqje e shoqëruar me dokumentet dhe evidencat e tjera, duhet të jetë e mjaftueshme për nga forma dhe përmbajtja për ta bindur Fondin që Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga huaja shumën, dhe që shuma që tërhiqet nga kjo hua përdoret vetëm për qëllimet e caktuara në Marrëveshje.

3.06. Huamarrësi do t'i përdorë të ardhurat e huasë vetëm për të financuar koston e mallrave të kërkuara për të kryer projektin e përshkruar në listën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Mallrat specifike që financohen prej huasë, metodat dhe procedurat për sigurimin e këtyre mallrave, do të përcaktohen me marrëveshje midis Fondit dhe Huamarrësit, e cila mund të ndryshohet me marrëveshje midis tyre.

3.07. Huamarrësi do t'i përdorë të gjitha mallrat e financuara prej të ardhurave të huasë vetëm në realizimin e projektit.

3.08. Pagesa nga Fondi e shumave të cilat Huamarrësi ka të drejtë t'i tërheqë nga huaja, do të bëhen me urdhër të Huamarrësit.

3.09. E drejta e Huamarrësit të tërheqë nga huaja, do të përfundojë më 30 qershor 2009 ose në një datë tjetër për të cilën mund të bihet dakord herë pas here midis Huamarrësit dhe Fondit.

Neni 4

Marrëveshjet e veçanta

4.01. (a) Huamarrësi do t'i besojë njësisë së zbatimit të projektit, e themeluar brenda rregulloreve të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit nr.166, datë 29 mars 2004 (këtëj e tutje e quajtur njësia), kryerjen e projektit dhe, për këtë qëllim, do t'i sigurojë këtë hua kësaj njësie.

b) Huamarrësi do t'i sigurojë njësisë staf të përshtatshëm, të gjitha mjetet dhe fondet e nevojshme për zbatimin e projektit me efikasitet.

c) Huamarrësi do të ngrrejë një komitet drejtues të kryesuar nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, ku do të përfshihen drejtorët e departamenteve përkatëse brenda Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe një përfaqësues nga Ministria e Financave për aprovimin e skemave nën komponentin 1 të projektit, monitorimin dhe zbatimin të tyre.

4.02. Për zbatimin e komponentit 1 të projektit, Huamarrësi do të zgjedhë skemat sipas mënyrës së mëposhtme:

a) për rehabilitimin e sistemeve ujitëse, e kulluese dhe për mbrojtjen nga përmbytjet e përfshira nën komponentin 1 të projektit, do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Fondit një studim fesibiliteti ekonomiko-teknik, së bashku me një vlerësim mjedisor për çdo skemë të projektit për shqyrtim dhe miratim;

b) për riparimin e rezervuarëve dhe digave të përfshira nën komponentin 1 të projektit, do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Fondit një studim fesibiliteti ekonomiko-teknik, së bashku me një plan pune ku do të jepet përshkrimi, buxheti dhe afatet për çdo skemë të projektit për shqyrtim dhe miratim;

c) për SHPU-të e ngritura rishtas, të përgatisë dhe të dorëzojë një vlerësim të buxhetit për çdo skemë për të mundësuar shqyrtimin dhe miratimin nga ana jonë.

4.03. Huamarrësi:

a) për rehabilitimin e sistemeve ujitës, do të hyjë në marrëveshje transferte midis tij dhe përfituesve me terma dhe kushte të cilat do të sigurojnë, midis të tjerash, një zbatim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje efikase të skemave të projektit;

b) do të koordinojë, monitorojë realizimin e komponentit 1 dhe do të supervizojë plotësimin e detyrimeve nga ana e përfituesve në përputhje me marrëveshjet respektive, politikat dhe procedurat sipas ligjit të ujitjes dhe kullimit, të cilat mundësojnë arritjen e objektivave të projektit.

4.04. Në kuadrin e huasë dhe të shumës së dislokuar nga IDA për projektin, Huamarrësi do t'i përdorë menjëherë të gjitha shumat e tjera të nevojshme në monedhë lokale apo të huaj, që do të kërkohen për realizimin e projektit, apo të çdo kostoje tjetër që mund të rezultojë, sipas afateve dhe kushteve të kënaqshme për Fondin.

4.05. Huamarrësi do të ngarkojë njësinë që të njoftojë Fondin për përgatitjen, studimet, planet dhe specifikimet për projektin, afatet e ekzekutimit të tij dhe ndonjë modifikim material të bërë këtej e tutje, me ato hollësi si mund t'i kërkojë Fondi kohë pas kohe.

4.06. Huamarrësi do të ngarkojë njësinë që të kryejë projektin me kujdesin dhe efektivitetin e duhur, si dhe në përputhje me praktikën e plotë inxhinierike, bujqësore, administrative dhe financiare.

4.07. Për të kryer projektin, Huamarrësi do të ngarkojë njësinë që të punësojë konsulentë, inxhinierë të përshtatshëm dhe, sipas afateve dhe kushteve të kënaqshme për Fondin, të përgatisë dokumentet për tenderat e punimeve civile dhe supervizionin e punimeve të projektit.

4.08. Dhënia e kontratave për kryerjen e projektit, të cilat do të financohen nga procedurat e huasë, dhe çdo ndryshim në to do të jenë subjekt i aprovimit të Fondit.

4.09. (a) Huamarrësi do të ngarkojë njësinë që të mbajë dokumentacione të përshtatshme për të identifikuar mallrat e financuara prej huasë, të sigurojë përdorimin e tyre vetëm për projektin, të ndjekë progresin e projektit (duke përfshirë edhe koston) dhe të reflektojë në përputhje me praktikën e llogarisë së plotë praktikën financiare dhe veprimtarinë e njësisë, do të krijojë mundësitë për përfaqësuesit e akredituar të Fondit që të bëjnë vizita për qëllime lidhur me huanë, të shqyrtojnë projektin, mallrat dhe çdo dokument përkatës, dhe do t'i japë Fondit të gjitha informacionet që Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimet që lidhen me huanë, projekt mallrat dhe gjendjen financiare dhe veprimtarinë e njësisë në lidhje me projektin.

b) Huamarrësi do të ngarkojë njësinë: (i) të mbajë një llogari speciale për Fondin; (ii) të mbajë dokumentacionin e burimeve financiare dhe kostot përkatëse; dhe (iii) të kryejë kontrole periodike për të siguruar që dokumentacioni financiar është besueshëm, i kompletuar dhe në përputhje me afatet kohore.

c) Huamarrësi do të ngarkojë njësinë që, në përputhje me projektin, të mbajë në dispozicion gjendjen e saj financiare për çdo kontroll financiar vjetor që do të kryhet nga revizorë të pavarur e të pranuar nga Fondi në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar dhe të sigurojë Fondin brenda një periudhe 6-mujore nga mbyllja zyrtare e vitit financiar me një kopje të vlerësimeve të kontrollit financiar.

d) Huamarrësi do të ngarkojë njësinë që brenda një periudhe 6-mujore nga mbyllja zyrtare e vitit financiar t'i sigurojë Fondit: (i) një buxhet të konsoliduar që të tregojë të ardhurat dhe shpenzimet e FSHPU-ve dhe SHPU-ve brenda zonës ku shtrihet projekti; dhe (ii) një kontroll financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve të konsoliduar për secilën nga FSHPU-të apo SHPU-të e përmendura më lart.

4.10. Huamarrësi do të ngarkojë njësinë për të garantuar me sigures të përshtatshëm të gjitha mallrat e financuara prej huasë. Një sigurim i tillë do të mbulojë rreziqe të tilla si transporti dhe incidente të tjera me rrezik për blerjet dhe importet e mallrave në territoret e Huamarrësit dhe dorëzimit të tyre në zonën e projektit, dhe do të jetë për shumën të tilla, sa do të jenë edhe praktikën e plota tregtare. Ky sigurim do të paguhet me monedhën me të cilën paguhet kostoja e mallrave të siguruar ose me monedhën e konvertueshme lirisht.

Huamarrësi do të ngarkojë njësinë të nxjerrë e të mbajë, me sigures të përshtatshëm përgjegjës, sigurimin kundrejt rreziqeve në zbatimin e projektit në shumën të tilla të pajtueshme me praktikën tregtare.

4.11. Huamarrësi dhe Fondi do të koeporojnë plotësisht për të siguruar realizimin e qëllimit të huasë. Në fund, Huamarrësi do të caktojë njësinë t'i japë Fondit çdo tre muaj nga data e kësaj Marrëveshjeje, raporte periodike për ekzekutimin e projektit dhe gjendjen e përgjithshme të huasë, si dhe informacione të tjera që Fondi do të kërkojë në lidhje me projektin dhe huanë.

Huamarrësi dhe Fondi, kohë pas kohe, do të shkëmbejnë mendimet nëpërmjet përfaqësuesve të tyre përsa përket çështjeve lidhur me qëllimin e huasë dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të saj. Huamarrësi do të njoftojë Fondin menjëherë për çdo kusht që ndërhyr ose kërcënon të ndërhyjë në realizimin e qëllimeve të huasë (duke përfshirë rritjen themelore në koston e projektit) ose në mirëmbajtjen e shërbimeve të saj.

4.12. Huamarrësi do të marrë të gjitha masat që do të jenë të nevojshme për ekzekutimin e projektit dhe nuk do të marrë ose nuk do të lejojë që të merret ndonjë veprim që pengon ose ndërhyr në ekzekutimin e projektit ose kryerjen e ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

4.13. Huamarrësi do të ngrëjë, jo më vonë se 31 mars 2005, 6 borde të tjera kullimi në përputhje me ligjin e ujitjes dhe kullimit.

4.14. Huamarrësi:

a) përpara se të mbarojë projekti, do të të riparojë të gjitha linjat elektrike të dëmtuara dhe instalimet, në mënyrë që të sigurohet furnizimi me energji të pandërprerë i stacioneve të ujitjes dhe hidrovoreve në zonën e projektit.

b) do të riparojë dhe mirëmbajë gjatë gjithë kohës rrugët rurale në zonën e projektit në mënyrë që të kemi akses në zonën e projektit.

c) do të sigurojë qëndrueshmërinë e digave (veçanërisht atyre të vogla e të mesme, si dhe rezervuarëve) në zonën e projektit gjatë të gjithë kohës dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për të arritur objektivin e sipërmendur.

e) do të monitorizojë periodikisht bilancin ujor në zonën e projektit dhe të sigurojë shpërndarjen e sasisë së nevojshme të ujit në këtë zonë.

4.15. Huamarrësi do të vazhdojë të punësojë, deri në mbylljen e projektit, një drejtor të njësisë, eksperiencë dhe kualifikimi i të cilët gjatë gjithë kohës do të jetë i pranueshëm nga Fondi.

4.16. Huamarrësi:

a) do të sigurojë që projekti të jetë funksional dhe të mirëmbahet, do të funksionojnë dhe mirëmbahen veprat e artit dhe objektet e tjera që nuk përfshihen në projekt, por ndikojnë në të, në përputhje me praktikën inxhinierike, bujqësore, financiare dhe administrative.

b) do të sigurojë që njësia do të pajisë Fondin menjëherë pas ekzekutimit të marrëveshjes, për rishikim dhe aprovim, me një kopje të manualit të shfrytëzimit, në të cilin jepen procedurat e detajuara për supervizionin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin, supervizionin dhe trajnimin e përfituesve në zonën e projektit.

4.17. Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në çdo kohë, për minimizimin e çdo efekti të dëmshëm për sa i përket ambientit në zonën e projektit, efekt ky që mund të lindë si shkak i zbatimit të projektit apo gjatë shfrytëzimit. Veçanërisht, Huamarrësi, me qëllim që të evitohet impaktet e dëmshme të reshjeve të tepërta dhe depozitimeve të ngurta në rezervuare, kanale dhe shtrate lumenjsh, të kontrollojë marrjen e inerteve nga lumenjtë dhe depozitimet e mbetjeve industriale.

4.18. Huamarrësi duhet të zhvillojë, gjatë zbatimit të projektit, një program trajnimi dhe aktivitete bazuar në nevojat e përfituesve në zonën e projektit, në të gjitha aspektet e menaxhimit të ujitjes dhe të aplikimit të teknikave e metodave moderne. Njësia duhet të mbikëqyrë zbatimin me efikasitet të programit të lartpërmendur. Gjithashtu, njësia duhet të zhvillojë një program të përshtatshëm trajnimi për trajnimin e trajnuesve, si dhe për stafin e Departamentit të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

4.19. Huamarrësi do të sigurojë që njësia do të vazhdojë të funksionojë gjatë gjithë kohës sipas rregullave dhe rregulloreve dhe të ketë fuqi të tillë që të drejtojë dhe administrojë, për sa është e nevojshme, kryerjen me kujdes dhe efektivitet të projektit dhe shfrytëzimin e mëtejshëm të tij.

Huamarrësi, nën dritën e një kooperimi të frytshëm dhe duke bindur të dyja Palët, do të informojë Fondin për çdo veprim të propozuar, cili do të ndikonte në natyrën ose ndërtimin e njësisë, si dhe do t'i japë Fondit të gjitha rastet e mundshme, përpara ndërmarrjes së një veprimi të tillë, për t'i rishikuar këto ndryshime së bashku me Huamarrësin për sa i takon më sipër.

4.20. Është qëllimi reciprok i Huamarrësit dhe Fondit që asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të gëzojë ndonjë prioritet mbi huanë, nëpërmjet të drejtës së krijuar mbi pasurinë shtetërore. Huamarrësi merr përsipër që, përveç rasteve kur Fondi do të bjerë dakord ndryshe, në qoftë se do të krijohet ndonjë lënie pengu në pasurinë e Huamarrësit, si siguri për borxhin e jashtëm, ky lloj pengu do të përdoret si siguri për pagimin e shumës kryesore të huasë, të interesit dhe të detyrimeve të tjera. Dispozitat e mëparshme të këtij paragrafi nuk do të zbatohen në:

i) ndonjë lënie pengu të krijuar në pasuri (pronë) vetëm si siguri për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj prone;

ii) ndonjë lënie pengu në mallrat tregtare për të siguruar një maturim borxhi jo më shumë se një vit pas datës në të cilën ajo ndodh, si dhe për ta paguar prej të ardhurave të shitjes së këtyre të ardhurave tregtare;

iii) ndonjë lënie pengu e krijuar në drejtim të transaksioneve të bankës dhe të sigurimit të një maturimi të borxhit jo më shumë se një vit pas datës së dhënies.

Termi “pasuri” e Huamarrësit, siç është përdorur në këtë paragraf, përfshin pasuritë e Huamarrësit ose të atij që ka të drejtë pronësie apo kontrolli nga Huamarrësi, ose nga ndonjë nënseksion politik, duke përfshirë bankën qendrore të Huamarrësit ose ndonjë institucion tjetër që kryen funksionet e Bankës dhe termi “peng” përfshin lënien peng, detyrimet, privilegjet dhe prioritetet e çdo lloji.

4.21. Shuma themelore, interesi dhe të gjitha detyrimet e tjera mbi huanë, do të paguhet pa zbritje dhe pa përfshirë taksat që janë në fuqi sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve faktike në territorin e tij, ose që do të jenë në të ardhmen.

4.22. Kjo Marrëveshje do të jetë e çliruar nga çdo taksë, tatim, kuotë e çdo lloji, që do të vihen sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve faktike në territorin e tij; gjithashtu Huamarrësi do të paguajë taksat, tatime e kuota të tilla, në qoftë se ka, sipas ligjeve të vendit ose vendeve me monedhën e të cilëve paguhet huaja, apo ligjeve në territoret e këtij apo këtyre vendeve.

4.23. Shuma kryesore, interesi dhe detyrimet e tjera të huasë do të paguhet të çliruara nga të gjitha kufizimet, duke përfshirë dhe kufizimet e këmbimit të vëna sipas ligjeve të Huamarrësit.

4.24. Të gjitha dokumentet, korrespondencat dhe materialet e tjera të ngjashme të Fondit, do të konsiderohen nga Huamarrësi si çështje sekrete. Huamarrësi do t'i akordojë Fondit imunitet të plotë nga censurimi dhe inspektimi i botimeve.

4.25. Të gjitha pasuritë dhe të ardhurat e Fondit do të çlirohen nga konfiskimi dhe shtetëzimi.

Neni 5

Anulimi dhe pezullimi

5.01. Huamarrësi, me anë të njoftimit të Fondit, mund të anulojë ndonjë shumë të huasë, shumë të cilën ai nuk e ka tërhequr para një njoftimi të tillë. Huamarrësi nuk mund të anulojë ndonjë shumë të huasë për të cilën Fondi do të ketë filluar një bisedim të veçantë sipas paragrafit 3.02 të kësaj Marrëveshjeje.

5.02. Fondi, nëpërmjet njoftimit të Huamarrësit, mund të pezullojë pjesërisht ose tërësisht të drejtën e Huamarrësit për të tërhequr nga huaja, në qoftë se ndodh dhe vazhdon ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme:

a) Kur ndodh një gabim në pagesën e shumës kryesore, në interesat ose pagesat e tjera të kërkuara sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të huasë midis Huamarrësit dhe Fondit;

b) Kur ndodh ndonjë gabim në kryerjen e ndonjë marrëveshjeje ose kontrate nga ana e Huamarrësit brenda kësaj Marrëveshjeje.

c) Fondi do të pezullojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të tërhequr sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër të huasë midis Huamarrësit dhe Fondit për shkak të ndonjë gabimi nga ana e Huamarrësit;

d) Fondi i IDA-s dhe i OPEC-ut i dislokuar për projektin do të anulohet apo pezullohet dhe Huamarrësi nuk ka siguruar ndonjë alternativë tjetër për financim dhe kohë të arsyeshme dhe kushte të pranueshme nga Fondi;

e) Një situatë e jashtëzakonshme, e cila do ta bëjë të pamundur Huadhënësin të plotësojë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes.

Për çdo ngjarje që ndodh pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe përpara datës efektive që do t'i japë të drejtë Fondit të pezullojë të drejtën e Huamarrësit për të bërë kërkesë dhe në qoftë se Marrëveshja është bërë efektive në datën që ka ndodhur ngjarja, Fondi ka të drejtë të pezullojë kërkesat nën huanë, njësoj sikur kjo ngjarje të ketë ndodhur pas datës efektive.

E drejta e Huamarrësit për të bërë kërkesa për huanë do të vazhdojë të mbetet e pezulluar, pjesërisht ose tërësisht, sipas rastit, përderisa ngjarja ose ngjarjet që shkaktuan një pezullim të tillë kanë pushuar së ekzistuari ose derisa Fondi do të njoftojë Huamarrësin që e drejta për të bërë kërkesë i është rikthyer; duke kuptuar që në rast të një njoftimi të tillë, e drejta për të bërë kërkesë do të rikthehet vetëm pas përmbushjes së kushteve të specifikuara në një njoftim të tillë, dhe njoftime të tilla nuk do të ndikojnë ose dëmtojnë ndonjë të drejtë, fuqi ose ndihmë të Fondit kundrejt ndonjë ngjarjeje të mëpasshme të përshkruar në këtë paragraf.

5.03. Në qoftë se do të ndodhë ndonjë ngjarje e specifikuar në pikën (a) të paragrafit 5.02 dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 30 ditësh pas njoftimit të dhënë nga Fondi Huamarrësit ose në qoftë se do të ndodhë një ngjarje e specifikuar në paragrafët (b), (c), (d) dhe (e) të paragrafit 5.02 dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 60 ditësh, atëherë në kohën pasuese në vazhdimësi, Fondi mund të deklarojë që shuma kryesore e huasë të paguhet menjëherë dhe sipas një deklarate të tillë, kjo shumë e huasë do të paguhet menjëherë.

5.04. Në qoftë se: (a) e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja do të pezullohet për një periudhë 30 ditëshe; ose (b) në datën e specifikuar në paragrafin 3.09 si data e mbylljes, një shumë e huasë do të mbetet e patërhequr; Fondi, nëpërmjet njoftimit të Huamarrësi, mund t'i japë fund të drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqjen e kësaj shume. Me dhënien e këtij njoftimi, kjo shumë e huasë do të anulohet.

5.05. Anulimet dhe pezullimet nga Fondi nuk do të zbatohen për shumën e huasë për angazhimet e veçanta të nisura nga Fondi në pajtim me paragrafin 3.02.

5.06. Vetëm në rastet kur Fondi do të bjerë dakord ndryshe, çdo pezullim do të zbatohet proporcionalisht në disa pagesa të shumës së huasë të bëra pas datës së këtij pezullimi.

5.07. Megjithë ndonjë pezullim ose anulim, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe efektive, përveç si përcaktohet në këtë nen.

Neni 6

Detyrimet e Marrëveshjes; pushimi i ushtrimit të të drejtave; arbitrazhi

6.01. Të drejtat dhe detyrimet e Fondit dhe Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme dhe të detyrueshme në përputhje me nenet e pandryshueshme të ligjeve lokale. As Huamarrësi dhe as Fondi nuk kanë të drejtën për të shpallur ndonjë kërkesë që sigurimi i kësaj Marrëveshjeje është i pavlefshëm ose jo e detyrueshme për ndonjë arsye.

6.02. Vonesat në ushtrimin ose lënia pas dore për të ushtruar çdo të drejtë ose fuqi të secilës palë sipas kësaj Marrëveshjeje për ndonjë të metë, do të dobësojë këtë të drejtë e fuqi, gjithashtu dhe pranimi në heshtje i kësaj të mete do të pengojë e dobësojë të drejtën, fuqinë e secilës palë përsa i përket të metave të tjera pasuese.

6.03. Çdo debat midis palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga cilado palë kundrejt tjetrës, do të vendoset me marrëveshjen e palëve dhe në rast dështimi të kësaj Marrëveshjeje, debati ose pretendimi do të paraqitet në arbitrazh nga një trup gjykues e parashikuar në paragrafin në vazhdim.

6.04. Trupi gjykues i arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjykatës të caktuar si më poshtë:
- arbitri i parë do të caktohet nga Huamarrësi;

- arbitri dytë do të caktohet nga Fondi; dhe
- arbitri i tretë (këtej e tutje quajtur arbitër) do të caktohet nga marrëveshja e palëve ose në qoftë se ato nuk do të jenë dakord, nga Presidenti Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me kërkesën e secilës palë. Në qoftë se secila palë nuk do të caktojë një arbitër, atëherë ky arbitër do të caktohet nga Presidenti Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e ndonjërës prej palëve. Në rast se arbitri, caktuar sipas këtij paragrafi jep dorëheqjen, vdes apo s'është i aftë për të vepruar, do të caktohet një arbitër tjetër pasardhës në të njëjtën mënyrë siç u përkrahua më lart, cili do të ketë të gjitha fuqitë dhe detyrat e arbitrit të parë.

Procedura gjyqësore e arbitrazhit mund të caktohet, sipas këtij paragrafi, me njoftimin nga pala që cakton këtë procedurë drejtuar palës tjetër. Ky njoftim do të përmbajë një deklaratë duke paraqitur natyrën e debatit ose pretendimit që paraqitet në arbitrazh, emrin e arbitrit të caktuar nga pala kundërshtarë.

Brenda 30 ditëve pas dhënies së këtij njoftimi, pala akuzuese njofton palën tjetër për procedurat e arbitrimin dhe emrin e arbitrit të emëruar nga kjo palë.

Në qoftë se brenda 60 ditëve pas dhënies së këtij njoftimi palët nuk do të jenë dakord për zgjedhjen e një arbitri, ato mund të kërkojnë zgjedhjen e arbitrit siç është përcaktuar në pjesën e parë të këtij paragrafi.

Trupi gjykues do të vendosë për kohën dhe vendin siç do të fiksohet nga arbitri. Pra trupi gjykues do të caktojë se ku dhe kur do të zhvillohet arbitrazhi.

Sipas neneve të këtij paragrafi dhe përveç rasteve kur palët do të bien dakord ndryshe, trupi gjykues do të vendosë të gjitha çështjet që lidhen me kompetencat e tij, si dhe do të vendosë procedurën. Këto vendime do të merren me shumicë votash. Trupi gjykues do t'i thërrasë të gjitha palët për të dëgjuar dhe për të dhënë vendimin e gjyqit me shkrim. Ky vendim mund të jepet edhe i gabuar, prandaj një vendim i nënshkruar nga shumica e trupit gjykues do të përcaktojë vendimin e këtij trupi. Një kopje e vendimit do t'i transmetohet secilës palë. Çdo vendim tillë i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët e kësaj Marrëveshjeje. Çdo palë duhet të zbatojë këtë vendim të trupit gjykues.

Palët do të fiksojnë shumën e kuotës së arbitrazhit dhe të personave të tjerë që do të kërkohen për drejtimin e procedurës së arbitrazhit. Nëse palët nuk do të bien dakord për një shumë të tillë para vendimit të trupit gjykues, atëherë trupi gjykues do të fiksojë këtë shumë sipas kushteve. Secila palë do të paguajë shpenzimet e veta në procedurën gjyqësore të arbitrazhit. Shpenzimet e trupit gjykues do të ndahen midis tyre dhe në mënyrë të barabartë nga palët. Çdo problem lidhur me ndarjen e shpenzimeve të trupit gjykues ose me procedurën për pagesën e këtyre shpenzimeve, do të caktohet nga trupi gjykues.

Trupi gjykues do të zbatojë parimet e përgjithshme sipas ligjeve në fuqi të Huamarrësit dhe shtetit të Kuvajtit, si dhe parimet e drejtësisë.

6.05. Dispozitat për arbitrazhin e paraqitur në paragrafin e mëparshëm, do të jenë të vlefshme për çdo procedurë tjetër, për përcaktimin e debateve midis palëve të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të çdo pretendimi të secilës palë ngritur kundrejt palës tjetër.

6.06. Shërbimi i çdo njoftimi ose procesi në lidhje me procedurat gjyqësore sipas këtij neni, mund të bëhet sipas mënyrës së cilësuar në paragrafin 7.01. Palët në këtë Marrëveshje mund të heqin dorë nga kërkesat për shërbimin e një procesi ose njoftimi të tillë.

Neni 7

Dispozita të ndryshme

7.01. Çdo njoftim apo kërkesë e lejuar ose e kërkuar për t'u bërë sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jetë me shkrim. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 8.03, ky njoftim apo kërkesë do të gjykohet të bëhet në kohën e duhur kur ai do të dorëzohet dorazi ose me postë, teleks, telegram ose telefon në adresën e palës së specifikuar në këtë Marrëveshje ose në adresa të tjera që janë përcaktuar nga njoftimi i palës që e ka bërë këtë kërkesë ose ka dhënë këtë njoftim.

7.02. Huamarrësi do të pajisë Fondin me evidencat e nevojshme të autorizimit të personit ose personave përgjegjës të cilët do të firmosin kërkesën e parashikuar në nenin 3, ose të personit që në emër të Huamarrësit do të fillojë të veprojë të plotësojë dokumentet e kërkuara apo të lejuara për t'u bërë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe firmat origjinale të secilit prej këtyre personave.

7.03. Çdo veprim i kërkuar apo i lejuar për t'u kryer, çdo dokument i kërkuar për t'u plotësuar sipas kërkesave të kësaj Marrëveshjeje, në emër të Huamarrësit, mund të kryhet nga Ministri i Financës apo ndonjë person autorizuar me shkrim nga ai. Çdo modifikim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet në emër të Huamarrësit, nga përfaqësuesi i sipërpërmendur ose çdo person i autorizuar me shkrim nga ai, duke u siguruar që, sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, ky modifikim është arsyetuar sipas kushteve dhe në thelb nuk do të rrisë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes. Fondi mund të pranojë kryerjen e veprimeve nga ky përfaqësues ose persona të tjerë, si dhe plotësimin e çdo dokumenti si përfundimtar që, sipas mendimit të tyre, ky apo ai modifikim i dispozitave të Marrëveshjes është i arsyeshëm dhe ky plotësim nuk do të rrisë detyrimet e Huamarrësit.

Neni 8

Data efektive; përfundimi

8.01. Fondi nuk do të jetë dakord me këtë Marrëveshje për ta bërë atë konkrete, derisa ai të jetë pajisur me evidencat e kënaqshme për të që:

a) ekzekutimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes në emër të Huamarrësit është autorizuar, miratuar nga të gjitha instancat e nevojshme qeveritare;

b) përveç rastit kur Fondi bie dakord ndryshe, huaja e IDA-s dhe OPEC-ut është ekzekutuar dhe është bërë ose do të bëhet efektive në të njëjtën datë në të cilën kjo Marrëveshje do të bëhet efektive.

8.02. Si pjesë e evidencës që duhet siguruar në vijim të paragrafit 8.01, Huamarrësi do t'i japë Fondit një opinion ose opinione të autoriteteve kompetente, duke treguar që kjo Marrëveshje është autorizuar, miratuar në kohë dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe që është një detyrim i vlefshëm i Huamarrësit sipas kushteve të saj.

8.03. Përveç rasteve kur Fondi dhe Huamarrësi bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe në veprim në datën në të cilën Fondi njofton me teleks Huamarrësin për pranimin e evidencave të kërkuara prej tij në paragrafin 8.01.

8.04. Në qoftë se të gjitha veprimet e kërkuara për t'u kryer sipas paragrafit 8.01, nuk do të jenë përfunduar para 90 (nëntëdhjetë) ditëve pasi të jetë nënshkruar kjo Marrëveshje apo në ndonjë datë tjetër që do të bien dakord Fondi dhe Huamarrësi, Fondi do t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet lajmërimit të Huamarrësit. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo Marrëveshje dhe gjithë detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë.

8.05. Në qoftë se dhe kur shuma kryesore e Huasë, interesi dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga huaja do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve do të marrin fund menjëherë.

Neni 9

Konkluzionet

9.01. Përveç rasteve kur kuptimi kërkohet ndryshe, termat që vijojnë kanë kuptimet e mëposhtme, kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje apo listë.

1) Termi “Projekt” do të thotë: projekt apo projekte, program apo programe për të cilat jepet huaja, siç përshkruhet në listën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe përshkrimi do të përmirësohet kohë pas kohe e Marrëveshjes midis Fondit dhe Huamarrësit.

2) Termi “mallra” do të thotë pajisje e shërbime të cilat kërkohen në projekt. Kudo ku është bërë referimi për koston e çdo malli, kjo kosto do të gjykohet duke përfshirë koston e importit të këtyre mallrave në territoret e Huamarrësit.

3) Termi “Përfitues” Federatat e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (FSHPU) dhe Shoqatat e Përdoruesve të Ujit (SHPU) dhe bordet e kullimit të cilat do të marrin pjesë në zbatimin e skemave të projektit të përfshirë nën komponentin 1.

4) Termi “borde kullimi”, referohet bordeve të kullimit sipas kapitullit 5 të ligjit të ujitjes dhe kullimit.

5) Termi “Federata e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit” i referohet kapitullit 4 të ligjit të ujitjes dhe kullimit.

6) Termi “Ligji i ujitjes dhe i kullimit” i referohet ligjit të vendit huamarrës nr.8515, datë 30 korrik 1999.

7) Termi “Unioni Kombëtar i Shoqatave të Përdoruesve të Ujit” i referohet organizmit të ngritur që vepron si kapacitet konsultiv për SHPU/FSHPU.

8) Termi “Komitet drejtues” i referohet komitetit të krijuar për monitorimin e zbatimit të projektit si dhe monitorimin e progresit të sektorit të reformave.

9) Termi “Skemë” i referohet skemave të identifikuar nga përfituesit, të aprovuara nga komiteti drejtues dhe ku do të kryhen punimet me fondet e alokuara nga projekti.

10) Termi “Njësi” i referohet njësisë së zbatimit të projektit, të krijuar në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit sipas rregullores nr.166, datë 29 mars 2004.

11) Termi “SHPU” i referohet shoqatave të përdoruesve të ujit të themeluara në përputhje me dispozitat e ligjit të ujitjes dhe kullimit.

Adresat që pasojnë janë dhënë për qëllime të paragrafit 7.01:

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:
MINISTRIA E FINANCAVE
BULEVARDI “DËSHMORËT E KOMBIT”
TIRANË, SHQIPËRI
ADRESA ALTERNATIVE ME TELEFON
DHE TELEKS
FAKS: 00355 42 28494

PËR FONDIN
FONDI KUVAJTIAN PËR ZHVLLIM
EKONOMIK ARAB
P. O. BOX 2921, SAFAT
KUWAIT -13030
ADRESA ALTERNATIVE ME TELEFON
DHE TELEKS:

TELEFON
ALSUNDUK
KUWAIT

TELEKS
22025 ALSUNDUK
22613 KFAED KT

FAKS
00965 2999091
00965 2999090

Në prani të dëshmitarëve, palët duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, e firmosën këtë Marrëveshje me emrat përkatës dhe e dorëzuan në Tiranë, në tri kopje, e konsideruar secila si origjinali, me të njëjtin efekt për sa përket datës dhe vitit të shkruar më sipër.

LISTA I DISPOZITAT E SHLYERJES

Shuma totale e huasë do të shlyhet në 36 këste gjashtëmujore, shuma dhe procedurat janë dhënë në listën bashkëngjitur. Kësti i parë do të paguhet datën e parë kur interesat dhe detyrime të tjera mbi huanë do të bëhen efektive, në përputhje me klauzolat e Marrëveshjes së huasë, pas një periudhe kohore ekstra 4-vjeçare, duke filluar që nga data kur Fondi paguan çdo shumë në vijim të kërkesës së parë për tërheqje të bërë nga Huamarrësi ose nga data në të cilën Fondi ndërmerr një veprim në përputhje me paragrafin 3.02 të Marrëveshjes së huasë, në rast se kërkohet ndërmarrja e një veprimi të tillë, cilado datë të jetë më e hershme se tjetra. Këstet e mbetura të shlyerjes do të paguhet në mënyrë të vazhdueshme, çdo gjashtëmujor, pas datës kur kësti i parë bëhet efektiv.

ANEKSI I LISTËS 1

LISTA E AMORTIZIMIT

SI.	Pagesa
Nr.	(E shprehur në dinarë kuvajtianë)
1	111.000
2	111.000
3	111.000
4	111.000
5	111.000
6	111.000
7	111.000
8	111.000
9	111.000
10	111.000
11	111.000
12	111.000
13	111.000
14	111.000
15	111.000
16	111.000
17	111.000
18	111.000
19	111.000
20	111.000
21	111.000
22	111.000
23	111.000
24	111.000
25	111.000
26	111.000
27	111.000
28	111.000
29	111.000
30	111.000
11	111.000
32	111.000
33	111.000
34	111.000
35	111.000
36	111.000
	115.000
Total	4.000.000
Dinarë kuvajtianë, katër milionë	

LISTA 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti synon të përmirësojë standardin e jetesës së fermerëve në zonën e projektit dhe të forcojë ekonominë e vendit nëpërmjet vazhdimin të rehabilitimit të sistemeve ujitëse dhe kulluese, stacioneve të pompimit, veprave të mbrojtjes nga përmbytjet, rezervuarëve dhe digave. Gjithashtu, projekti synon forcimin e reformës institucionale në sektorin e ujitjes dhe të kullimit, si dhe themelimin e forcimin e SHPU-ve, federatave të tyre dhe Unionit Kombëtar të SHPU-ve.

Projekti do të ketë këto komponentë kryesorë:

1. Rehabilitimi i sistemit: Projekti do të rehabilitojë sistemet ujitëse dhe kulluese me veprat e artit, stacionet e pompimit, veprat për mbrojtjen nga përmbytjet, riparime në rezervuare e diga duke mbuluar një sipërfaqe prej 50 000 ha në zona të ndryshme kundrejt kontributit të përfituesve. Projekti do të rehabilitojë një sipërfaqe kulluese prej rreth 30 000 ha.

2. Shërbime inxhinierike: do të mbulojnë përgatitjen e projekteve, dokumentacionit për tender, asistencë në procesin e tenderimit, supervizionit dhe ndërtimit. Gjithashtu, ato do të përmbajnë monitorimin dhe trajnimin e bordeve të kullimit dhe SHPU-ve në praktikat bujqësore dhe menaxhimin e ujit.

3. Mbështetje institucionale për ujitjen, kullimin dhe kontrollin e prurjeve:

Projekti do të vazhdojë të thellojë mbështetjen institucionale për SHPU-të, federatat e tyre, Union Kombëtar të sapongritur të SHPU-ve dhe për bordet e kullimit. Në veçanti, projekti do të ndihmojë si më poshtë:

a) Mbështetje për SHPU-të dhe federatat e tyre

Projekti do të mbështesë krijimin e SHPU-ve dhe federatave të tyre nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike, vendase e të huaj, pajisje e trajnime. Gjithashtu, projekti do të mbështesë Unionin Kombëtar të SHPU-ve nëpërmjet asistencës teknike dhe trajnimit në aspektet administrative dhe menaxhuese.

b) Mbështetje bordeve të kullimit

Projekti do të mbështesë bordet e kullimit në aspektet administrative, ligjore e teknike dhe në veçanti në përgatitjen, në rast përmbytje, të planeve të emergjencës dhe sistemeve të paralajmërimit.

c) Mbështetje menaxhimit të burimeve ujore

Projekti do të ndihmojë në hartimin e një kuadri institucional dhe ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri. Projekti do të sigurojë asistencë teknike dhe ligjore, vendase e të huaj, për kryerjen e trajnimeve, seminareve, studimeve për zonat e rrezikuara nga përmbytjet, planet e sigurisë dhe do të japë mbështetje autoriteteve të baseneve lumore e Komitetit Kombëtar të Ujit.

d) Njësia e projektit: Projekti do të financojë shpenzimet operative plus paga dhe asistencë teknike.

Projekti pritet të fillojë në fund të vitit 2004 dhe pritet të mbarojë në fund të vitit 2008.

Letër nr.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Data.....

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

P. O. Box 2921, Safat

Kuvajt, 13030

Të dashur zotërinj,

Lënda: Lista e mallrave për t'u financuar nga huaja

- Procedura për prokurim.

Duke iu referuar paragrafëve 3.06 dhe 4.08 të Marrëveshjes së kredisë lidhur me projektin e dytë të rehabilitimit të ujitjes (faza III), që është firmosur sot midis Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab dhe Shqipërisë, ne konfirmojmë që të ardhurat nga huaja do të shpërndahen për financimin e mallrave dhe shërbimeve sipas listës së bashkëngjitur në përqindjet dhe shumat e përmendura këtu. Ne jemi dakord se nëse Fondi gjen që alokimi për ndonjë zë është i pamjaftueshëm për financimin e përqindjes së specifikuar në listën e mallrave, jashtë kostos totale të parashikuar për këtë zë, ai do të marrë një nga këto masa si më poshtë:

a) Për të bërë alokimin për këtë zë, brenda limitit të shumës së nevojshme për të mbuluar mungesën e financimit sipas përqindjes së specifikuar, një shumë shtesë nga shuma e paalokuar e planifikuar si kontigjencë ose nga alokimi për një zë tjetër, nëse Fondi vë re se ka tepriçë në atë alokim.

b) Për të ulur përqindjen që do të financohet nga kredia nga kosto totale për një zë të veçantë, nëse alokimi shtesë për këtë zë, në përputhje me sa u thamë lart, është i pamjaftueshëm për të mbuluar mungesën e përmendur më lart, ose nëse Fondi ka mendimin se nuk ka mundësi të alokohet një shumë shtesë nga kredia për këtë zë, kështu që si rrjedhim kësaj i uljeje, tërheqjet nga kredia për financimin e mallrave, punimeve ose shërbimeve të përfshirë në këtë zë do të vazhdojnë derisa të mbulohet plotësisht kosto totale e tyre.

Ne, gjithashtu, konfirmojmë që asnjë e ardhur e huasë nuk do të përdoret për pagesat e taksave e detyrimeve të imponuara nga ligjet në fuqi të Shqipërisë. Ne, gjithashtu, konfirmojmë se kontratat për pajisje dhe pjesë këmbimi do të financohen nga huaja, për shuma që kalojnë vlerën prej 30 000 dinarë kuvajtianë do të prokurohen, përveç rasteve ku është rënë dakord ndryshe, nëpërmjet tenderit internacional. Për shuma më të vogla se 30 000 dinarë kuvajtjanë mund të prokurohet edhe me tenderim të drejtpërdrejtë nga ndonjë numër furnizuesish apo prodhuesish të përshtatshëm për këto lloj pajisjesh, me kusht që vlera agregate e këtyre zërave që do të prokurohen në mënyrë të tillë të mos kalojë shumën ekuivalente me 300 000 dinarë kuvajtjanë.

Fondi konfirmon se, përderisa nuk do bihet dakord ndryshe, prokurimi i të gjitha zërave të punimeve civile që do të financohen nga huaja do të vazhdojë të kryhet mbi bazë të tenderimit lokal në përputhje me procedurat e prokurimit të pranueshme nga Fondi.

Përsa i përket zbatimit të paragrafit 4.08 të referuar më sipër, prokurimit të zërave që do të financohen nga huaja, ne do t'ju pajisim me një kopje të dokumenteve të tenderit për të gjitha vlerat që do të kalojnë shumën ekuivalente me 30 000 dollarë kuvajtianë në avancë me qëllim që të shqyrtohet, komentohet dhe të bëhen modifikime të tilla sa mund të kërkohen nga ju në këto dokumente ose në procedurën e ofertës. Pas marrjes dhe analizës së ofertave, ne do t'ju pajisim me një raport të hollësishëm të vlerësimit të ofertave bashkë me rekomandimin për fituesin për mendimin dhe miratimin tuaj. Gjithashtu, çdo modifikim që do të propozohet për t'u bërë në lidhje me kushtet e ndonjë kontrate para ose pas lidhjes do të paraqiten për miratimin tuaj.

Është e qartë se, nëse ne, në përputhje me seksionin 3.02 të Marrëveshjes së kredisë, kërkojmë që Fondi të lëshojë një angazhim të posaçëm (special commitment) në lidhje me konfirmimin e një letre kredie për të përballuar shpenzimet e projektit, kjo kërkesë do të bazohet në faktin se angazhimi i posaçëm i Fondit do të bëhet në një bankë kuvajtiane që vepron në Kuvajt ose jashtë vendit.

Në vazhdim të nënshkrimit të kontratave, ne do t'ju pajisim me kopjet që konfirmojnë nënshkrimin e tyre për efekt dokumentacioni dhe shpenzim nga huaja lidhur me to.

Me qëllim që të sigurohet në kohë nënshkrimi i kontratave për ekzekutimin e projektit, do të përpilohet një program për fazat e tenderimit, vlerësimit të ofertave, nënshkrimit të kontratave të mëdha dhe ne do të ndërmarrim të gjitha hapat e nevojshme për t'ju përmbajtur këtij programi, si dhe do t'ju pajisim me një kopje të tij.

Lutemi, konfirmoni se jeni dakord për sa më sipër dhe për "Listën e mallrave" të bashkëngjitur, duke nënshkruar formularin e konfirmimit në kopjen e mbyllur me këtë letër dhe duke na e kthyer atë.

Republika e Shqipërisë

Nga: _____

(Përfaqësuesi i autorizuar)

Konfirmuar:

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

Nga: _____

(Përfaqësuesi i autorizuar)

LISTA E MALLRAVE

Nr.	Artikujt	Alokimi i shumës (në dinarë kuvajtianë)	Përqindja e kostos totale për artikull
1	Punime civile në ujitje dhe kullim	3 500 000	100%
2	Pajisje dhe mjete	50 000	100%
3	Kontigjent fizik	450 000	
	Shuma	4 000 000	
		(katër milionë dinarë kuvajtianë)	

Letër nr. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Datë.....

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

P. O.Box 2921, Safat

Kuvajt, 13030

Të dashur Zotërinj,

I referohemi Marrëveshjes së huasë të datës që është firmosur midis nesh për financimin e projektit të rehabilitimit të ujitjes. Ne konfirmojmë që jemi informuar siç duhet, që, në përputhje me rregullat në fuqi në shtetin e Kuvajtit, ndalohet përdorimi, fondeve publike në lidhje me transaksionet që përfshijnë tregtinë apo marrëdhëniet me firma apo kompani që bojkotojnë rregulla të tilla.

Prandaj, ne zotohemi që të ardhurat e huasë së sipërpërmendur nuk do të përdoren në asnjë mënyrë për të financuar direkt apo indirekt mallrat e prodhuara apo shërbimet e siguruar nga çdo vend apo firmë, duke bojkotuar rregullat në fuqi në shtetin kuvajtian.

Ju lutemi konfirmoni rënien dakord me sigurimin e mësipërm nëpërmjet nënshkrimit të një kopjeje të bashkëngjitur kësaj letre dhe ktheheni atë te ne.

LIGJ

Nr. 9350, datë 3.3.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE DHE TË PROTOKOLLIT TË SAJ”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit i saj.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4505, datë 17.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut, këtu referuar si “Pala Kontraktuese” ose “Palët Kontraktuese” sipas rastit,

duke dëshiruar të përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet dy Palëve Kontraktuese, me qëllim që të japin kontributin e tyre për të parandaluar dhe luftuar kalimin e paligjshëm të kufirit me qëllim migracionin,

duke dëshiruar të lehtësojnë ripranimin dhe transitin në rastet e dëbimit të personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm në territoret e shteteve të tyre,

duke pasur parasysh nevojën që të udhëhiqen nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat garantohen nga legjislacioni i tyre kombëtar dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi për Palët Kontraktuese,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje dhe protokollit të kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1) “Leje qëndrimi” do të thotë një autorizim i çdo lloji i lëshuar nga njëra Palë Kontraktuese, e cila e lejon personin të qëndrojë në territorin e asaj Pale Kontraktuese, me përjashtim të vizave dhe autorizimeve të përkohshme për qëndrim, lëshuar gjatë shqyrtimit të një aplikimi për një leje qëndrimi ose për azil.

2) “Shtetas” dhe “Shtetësi”, në konceptin e Republikës së Shqipërisë i referohen shtetasve shqiptarë dhe shtetësisë shqiptare dhe përsa i përket Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut, i referohen vetëm shtetasve britanikë dhe shtetësisë britanike.

3) “E drejta për të qëndruar” zbatohet vetëm përsa i përket Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut dhe ka kuptimin që është përcaktuar në legjislacionin përkatës kombëtar.

4) “Vizë” do të thotë një autorizim ose vendim nga një shtet ose territor, përfshirë ndonjë Palë Kontraktuese, e cila e lejon një person të hyjë dhe të mbetet në territorin e shtetit të saj, në rastet kur përmbushen kriteret në bazë të të cilave është lëshuar viza.

5) “Leje për transit” do të thotë çdo autorizim ose vendim ose çdo vizë që kërkohet nga një Palë Kontraktuese, të cilat e lejojnë një shtetas të një Pale të Tretë të kalojë transit nëpërmjet territorit të shtetit të saj ose të kalojë nëpërmjet zonës transit të një porti ose aeroporti, me kusht që kriteret e tjera të transitit të jenë të përmbushura.

6) “Shtetas i një pale të tretë” do të thotë një person i cili nuk ka shtetësinë e, ose të drejtën e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë ose në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, dhe “Shtet i palës së tretë” do të thotë çdo lloj vendi ose territori, përveç Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

7) “Ditë-pune” do të thotë çdo lloj dite e cila nuk është e shtunë, e dielë ose ditë feste zyrtare, në secilën prej Palëve Kontraktuese.

8) (a) Subjekt i nenit 1 (8) (c) më poshtë, me “Autoritete kompetente” për Republikën e Shqipërisë do të thotë:

i) për paraqitjen e një aplikimi tek autoritetet kompetente në Mbretërinë e Bashkuar, pranimin e një përgjigjeje të një kërkesë për procedurën për të siguruar një dokument udhëtimi nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Shqipërisë, dhe për të gjitha njoftimet për personat që do të kthehen në Mbretërinë e Bashkuar:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Rendit Publik;

ii) për pranimin e një aplikimi nga autoritetet kompetente të Mbretërisë së Bashkuar, për paraqitjen e një përgjigjeje të një kërkesë dhe për paraqitjen e të gjitha njoftimeve të personave që do të kthehen në Republikën e Shqipërisë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Rendit Publik;

iii) për lëshimin e pasaportave dhe dokumenteve të tjera të udhëtimit pas një përgjigjeje pozitive të kërkesës:

- Ambasada ose zyrat konsullore të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar.

8) (b) Subjekt i paragrafit (8) (c) më poshtë me “Autoritete kompetente” për Mbretërinë e Bashkuar do të thotë:

i) për paraqitjen e një aplikimi tek autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, pranimin e një përgjigjeje të një kërkesë, për procedurën për të siguruar një dokument udhëtimi nga përfaqësia diplomatike – konsullore shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar, dhe për të gjitha njoftimet për personat që do të kthehen në Republikën e Shqipërisë:

- Drejtoria e Imigracionit dhe Kombësisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

ii) për pranimin e një aplikimi nga Autoritetet Kompetente për Republikën e Shqipërisë, për paraqitjen e një përgjigjeje të një kërkesë dhe për paraqitjen e të gjitha njoftimeve të personave që do të kthehen në Mbretërinë e Bashkuar:

- Drejtoria e Imigracionit dhe Kombësisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

iii) për lëshimin e pasaportave dhe të dokumenteve të tjera të udhëtimit pas një përgjigjeje pozitive për kërkesën:

- Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Shqipërisë.

8) (c) Çdo lloj ndryshimi për përkufizimin e “Autoriteteve kompetente” të njëres nga Palët Kontraktuese do t’i njoftohet Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Çdo ndryshim i këtij lloji do të ketë efekt në ditën e punës, e cila pason marrjen e një njoftimi të tillë nga Pala tjetër Kontraktuese.

9) “Palë Kontraktuese kërkuese” do të thotë një Palë Kontraktuese, e cila bën një kërkesë për Palën Kontraktuese të kërkuar për të ripranuar një person ose për të lejuar kalimin transit, në përputhje me përcaktimet e kësaj marrëveshjeje dhe “Palë Kontraktuese e kërkuar” do të thotë Pala Kontraktuese të cilës i bëhet një kërkesë e tillë.

10) “I mitur ose “të mitur” do të thotë persona të cilët nuk kanë arritur moshën 18 vjeç në datën kur është bërë kërkesa për ripranimin.

11) “Me shkrim” do të thotë me shkrim në gjuhën angleze.

PJESA 1

RIPRANIMI I SHTETASVE DHE I PERSONAVE ME TË DREJTË QËNDRIMI

Neni 2

Detyrimi për të ripranuar

1. Pala Kontraktuese e kërkuar do të ripranojë, me kërkesë të Palës Kontraktuese kërkuese dhe pa ndonjë formalitet të veçantë, ndonjë person i cili nuk i plotëson ose nuk i plotëson më kërkesat për hyrje ose për qëndrim në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, në rast se ai person është saktësisht i identifikuar dhe kur kjo provohet në përputhje me paragrafin (1) të nenit

3 të kësaj Marrëveshjeje ose në rastet kur mund të prezumohet në mënyrë bindëse në përputhje me paragrafin (2) të nenit 3, që personi është një shtetas i Palës Kontraktuese të kërkuar ose një person tjetër me të drejtën për të qëndruar në Palën Kontraktuese të kërkuar, ose personi ishte (në hyrjen e tij të fundit për në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese) një shtetas i Palës Kontraktuese të kërkuar, por që më pas ka hequr dorë nga shtetësia e tij dhe që nuk i takon shtetësi ose kombësi tjetër.

2. Një Palë Kontraktuese kërkuese do të ripranojë, me kërkesë të Palës Kontraktuese të kërkuar dhe pa ndonjë formalitet të veçantë, çdo person i cili është larguar më parë nga territori i shtetit të saj në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, nëse nga verifikimet e mëtejshme rezulton se në kohën e largimit ai person nuk ishte shtetas i saj ose çdo person tjetër me të drejtën për të qëndruar në Palën Kontraktuese të kërkuar. Në një rast të tillë Pala Kontraktuese e cila e kishte pranuar atë person, do të kthejë të gjitha dokumentet e marra nga Pala tjetër Kontraktuese në lidhje me ripranimin fillestar. Detyrimi për të ripranuar në bazë të këtij paragrafi nuk do të zbatohet në rastet kur Pala Kontraktuese e kërkuar e ka privuar personin në fjalë nga shtetësia e tij/e saj ose nga e drejta për qëndrim, ose në rastet kur personi kishte hequr dorë ose lejuar që t'i hiqet shtetësia e tij/e saj ose e drejta e qëndrimit, pasi ai person kishte hyrë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, në rast se atij personi nuk i është bërë të paktën një premtim për natyralizim nga Pala Kontraktuese kërkuese.

Neni 3

Mjetet e përcaktimit të identitetit dhe shtetësisë të personave që do të ripranohen

1. Identiteti dhe shtetësia ose e drejta për qëndrim e çdo personi që do të ripranohet bazuar në paragrafin (1) të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje, do të provohen nëpërmjet njërit prej dokumenteve të vlefshme të mëposhtme:

- a) një dokument shtetëror identiteti (pavarësisht nëse është i momentit ose i përkohshëm), i cili duhet padyshim t'i përkasë atij personi; ose
- b) një pasaportë ose një dokument udhëtimi zëvendësues me fotografi (lejekalimi) ku të tregohet shtetësia dhe/ose zotërimi i së drejtës për qëndrim në një Palë Kontraktuese; ose
- c) një dokument udhëtimi për fëmijët në vend të pasaportës;ose
- d) regjistrat e shërbimit dhe fletëhyrje të ushtrisë.

2. Identiteti dhe shtetësia ose e drejta për qëndrim mund të prezumohen në mënyrë të arsyeshme nga sa më poshtë:

- a) një dokument, parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni, vlefshmëria e të cilit ka mbaruar, por që në mënyrë bindëse mund t'i përkasë personit;
 - b) ndonjë lloj dokumenti tjetër zyrtar, i cili ndihmon për identifikimin e personit në fjalë (p.sh.: një patentë makine);
 - c) shpjegime të protokolluara, rregullisht të dhëna nga dëshmitarë *bona fide* në prezencë të autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;
 - d) shpjegime të protokolluar, të dhëna nga personi në fjalë për autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;
 - e) gjuha e folur nga personi në fjalë;
 - f) një dokument identifikimi i kompanisë;
 - g) një përmbledhje e marrë nga të dhënat e regjistruara në zyrat e gjendjes civile;
 - h) pasaporta e detarit;
 - i) dokument identifikimi i maunës detare;
 - j) dokumente të tjera ku të ketë evidenca për identitetin e personit në fjalë;
 - k) fotokopje të dokumenteve të lartpërmendura,
- si dhe ndonjë lloj prove të pranueshme nga të dyja Palët Kontraktuese, e cila mund të ndihmojë për të vërtetuar shtetësinë ose të drejtën për qëndrim të personit në fjalë.

Neni 4
Kërkesat për ripranim

1. Ndonjë kërkesë për ripranim, në bazë të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim dhe do të përmbajë informacionin i cili është sqaruar në nenin 1 të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për ripranim do të dorëzohet tek autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar.

Neni 5
Përgjigjja për kërkesën

1. Përgjigjja për kërkesën për ripranim në bazë të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar për autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese në bazë të procedurës dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 6 të Marrëveshjes.

2. Përgjigjja për kërkesën do të përmbajë informacionin i cili është përcaktuar në nenin 2 të Protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Afatet kohore

1. Me përjashtim të atyre kërkesave të parashtruara në evidencat e përcaktuara në paragrafin (1) të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, përgjigjet për kërkesat e ripranimit të bëra në bazë të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje do të jepen me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditësh-pune nga data e dorëzimit të kërkesës. Çdo refuzim për ripranim duhet të jetë i argumentuar.

2. Në rast se një kërkesë për ripranim e bërë në bazë të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje bazohet në dokumentet e përcaktuara në paragrafin (1) të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, një përgjigje do të jepet brenda dhjetë ditësh-pune nga data e dorëzimit të kërkesës.

3. (a) Në rast se dokumentet e dorëzuara dhe faktet nuk janë të pamjaftueshme ose të kontestueshme, zyrtarët kompetentë konsullorë të Palës Kontraktuese të kërkuar mund t'i kërkojnë Palës Kontraktuese kërkuese të intervistojë personin në fjalë brenda një afati kohor më të shkurtër, dhe mund të jenë edhe vetë prezent në intervistën në fjalë.

3. (b) Për kohën dhe vendin e intervistës duhet të bihet dakord në mënyrë të përbashkët. Kërkesa për një intervistë të tillë do të paraqitet nga Pala Kontraktuese e kërkuar brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni. Përgjigjja për kërkesën e ripranimit do të jepet me shkrim brenda dhjetë ditësh-pune nga data e intervistës.

4. Pala Kontraktuese kërkuese do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar largimin ose nisjen nga territori i shtetit të saj të personit, për ripranimin e të cilit është rënë dakord në përputhje me këtë Marrëveshjeje brenda tridhjetë ditësh-pune nga data e marrjes së miratimit të Palës Kontraktuese të kërkuar. Ky afat kohor mund të zgjatet për aq kohë që është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme që të zgjidhen pengesat ligjore ose praktike.

PJESA II
RIPRANIMI I SHTETASVE TË PALËS SË TRETË

Neni 7
Shtetasit e palës së tretë me viza ose me lejeqëndrimi

1. Siç ishte objekti i paragrafit (2) të këtij neni, secila Palë Kontraktuese do të ripranojë me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa formalitete të panevojshme çdo shtetas të palës së tretë, i cili nuk i plotëson ose nuk i plotëson më rregullat e hyrjes ose të qëndrimit në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, me kusht që ai të ketë një vizë të vlefshme ose një lejeqëndrimi të

vlefshme të lëshuar nga Pala Kontraktuese e kërkuar dhe kur i plotëson kërkesat e legjislacionit të saj kombëtar për hyrje dhe për qëndrim për të huajt.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e paragrafit (1) të këtij neni, në rastet kur të dyja Palët Kontraktuese kanë lëshuar viza ose lejeqëndrimi, përgjegjësia i mbetet Palës Kontraktuese, viza ose leja e qëndrimit të së cilës skadon e fundit.

Neni 8

Shtetasit e palës së tretë të cilët kanë hyrë ose qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar

1. Secila Palë Kontraktuese do të ripranojë në territorin e shtetit të saj me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa formalitete të panevojshme, ndonjë shtetas të palës së tretë, i cili nuk plotëson ose nuk i plotëson më kushtet në fuqi për hyrje ose për qëndrim në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese me kusht që ajo është dokumentuar, në përputhje me paragrafin (1) të nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje, ose prezumohet në mënyrë të arsyeshme, në përputhje me paragrafin (2) të nenit 9 që një shtetas i tillë i një pale të tretë kishte hyrë ose kishte qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Asnjë detyrim për ripranim nuk do të ekzistojë në bazë të klauzolave të paragrafit (1) të këtij neni për:

a) Shtetas të palës së tretë për të cilët Pala Kontraktuese kërkuese ka pranuar statusin e refugjatit në bazë të konventës e cila ka të bëjë me Statusin e Refugjatit bërë në Gjenevë, më 28 korrik 1951 dhe me protokollin bërë në Nju-Jork, më 31 janar 1967, duke plotësuar konventën e përmendur ose statusin e personave pa shtetësi, siç është përcaktuar nga konventa që ka të bëjë me statusin e personave pa shtetësi, bërë në Nju-Jork, më 28 shtator 1954¹ ;

b) Shtetas të palës së tretë, shteti i shtetësisë së të cilëve ka një kufi të përbashkët me territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, si edhe shtetas të tjerë të palës së tretë me qëndrim të përhershëm në territorin e një shteti të tillë të palës së tretë;

c) Shtetas të palës së tretë të cilët Pala Kontraktuese e kërkuar i ka kthyer më parë në vendet e tyre të origjinës ose në ndonjë shtet tjetër të palës së tretë, tek i cili hyrja e tyre është siguruar;

d) Shtetas të Palës së tretë të cilët kanë leje për të transituar nga Pala Kontraktuese e kërkuar, bazuar në një vizë të vlefshme ose në një lejeqëndrimi të vlefshme, të lëshuara nga një shtet i mëvonshëm tranzitimi ose destinacioni;

e) Shtetas të palës së tretë të cilët kanë leje për të trasituar nga Pala Kontraktuese e kërkuar në rastet kur atyre nuk u duhet vizë ose lejeqëndrimi për të hyrë ose për të qëndruar në një shtet të mëvonshëm transitimi ose destinacioni;

f) Shtetas të palës së tretë të cilët pasi janë larguar nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar, fillimisht kanë hyrë ose qëndruar në territorin e shtetit të një pale të tretë, përveç atyre personave të cilët kanë kaluar përmes zonës së transitit, në mënyrë që të arrijnë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese;

g) Shtetas të palës së tretë të cilët kanë mbajtur një lejeqëndrimi të vlefshme, të lëshuar nga Pala Kontraktuese kërkuese për një periudhë prej më shumë se gjashtë muajsh. Për të shmangur ndonjë dyshim, një lejeqëndrimi e përjashton një vizë dhe ndonjë autorizim të përkohshëm për qëndrim lëshuar gjatë shqyrtimit të një aplikimi për lejeqëndrimi ose për azil.

Neni 9

Prezumimi i hyrjes ose i qëndrimit

1. Hyrja ose qëndrimi i shtetasve të palës së tretë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar do të dokumentohet nga vendosja e vulave të kufirit ose nga shenja të tjera të përshtatshme të vendosura në dokumentet e tyre të udhëtimit nga autoritetet e kontrollit të kufirit të Palës Kontraktuese të kërkuar, në hyrje ose në dalje nga territori i shtetit të saj.

¹ Republika e Shqipërisë nuk është nënshkruese e kësaj konvente

2. Hyrja ose qëndrimi i shtetasve të palës së tretë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar mund të prezumohet në mënyrë bindëse në bazë të:

- a) dokumenteve të transportit;
- b) provës së pagesës për hotel, shërbime mjekësore ose shërbime të tjera etj.;
- c) evidenca të protokolluara të paraqitura nga dëshmitarë *bona fide*, të dorëzuara tek autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;
- d) evidenca të protokolluara të dhëna nga shtetasi i palës së tretë për autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese.

Neni 10

Kërkesa për ripranimin e shtetasve të palës së tretë

1. Një kërkesë për ripranim të shtetasve të palës së tretë në bazë të nenit 7 ose 8 të kësaj Marrëveshjeje, do të dorëzohet me shkrim dhe do të përmbajë informacionin i cili është përcaktuar në nenin 4 të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për ripranim në bazë të paragrafit (1) të nenit 7 dhe paragrafit (1) të nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje do t'i dorëzohet autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Përgjigjja për kërkesën për ripranimin e bërë në bazë të nenit 7 ose 8 të kësaj Marrëveshjeje do të jepet me shkrim, brenda pesëmbëdhjetë ditësh-pune nga data e marrjes së saj. Çdo refuzim duhet të jetë i argumentuar.

4. Pala Kontraktuese kërkuese do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar largimin ose nisjen nga territori i shtetit të saj të personit, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, në përputhje me këtë marrëveshje, brenda tridhjetë ditësh-pune nga data e marrjes së miratimit të Palës Kontraktuese të kërkuar. Ky afat kohor mund të zgjatet për aq kohë sa është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme që të zgjidhen pengesat ligjore ose praktike.

Neni 11

Përgjigjja për kërkesën

1. Përgjigjja për kërkesën për ripranim në bazë të nenit 7 ose 8 të kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar për autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese në bazë të procedurës dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Përgjigjja për kërkesën do të përmbajë informacionin e përcaktuar në nenin 5 të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Detyrimi për të ripranuar

1. Secila Palë Kontraktuese do të ripranojë me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa ndonjë formalitet të veçantë, ndonjë shtetas të palës së tretë, i cili është nisur ose larguar nga territori i shtetit të saj, konform klauzolave të paragrafit (1) të nenit 7 të kësaj Marrëveshjeje, kur nga verifikimet e mëvonshme rezulton se personi i ripranuar, në kohën e largimit nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese nuk kishte një vizë të vlefshme ose një lejeqëndrimi të vlefshëm, e cila i jepte të drejtën të hynte dhe të qëndronte në shtetin e Palës Kontraktuese të kërkuar, në përputhje me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rastet kur klauzolat e paragrafit (1) të këtij neni aplikohen, Pala Kontraktuese e cila në fillim ka ripranuar persona të tillë, do të informojë Palën tjetër Kontraktuese për arsyet për refuzimin e tyre dhe do të kthejë të gjitha dokumentet e marra në lidhje me procedurën fillestare të ripranimit.

3. Secila Palë Kontraktuese do të ripranojë me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa ndonjë formalitet të veçantë, ndonjë shtetas të palës së tretë, i cili është nisur ose është larguar nga territori i shtetit të saj, konform klauzolave të paragrafit (1) të nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, kur nga verifikimet e mëvonshme rezulton se personi i ripranuar, në kohën e largimit nga territori i Shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, në fakt nuk kishte hyrë ose qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese, të kërkuar në përputhje me nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Në rastet kur klauzolat e paragrafit (3) të këtij neni aplikohen, Pala Kontraktuese e cila fillimisht i ka ripranuar persona të tillë, do të informojë Palën tjetër Kontraktuese për arsyet për refuzimin e tyre dhe do të kthejë të gjitha dokumentet e marra në lidhje me procedurën fillestare të ripranimit

PJESA 3 TRANSITI

Neni 13

Detyrimi për të lejuar transitimin

1. Secila Palë Kontraktuese do të lejojë me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese, transitimin nëpërmjet territorit të shtetit të saj për shtetasit e Palës së tretë të larguar nga Pala Kontraktuese kërkuese për qëllim të ripranimit për në vendet e tyre të origjinës ose për te shtetet e palës së tretë nëse:

a) pranimi në ndonjë shtet tjetër transiti dhe në shtetin e destinacionit është i siguar; dhe

b) Pala Kontraktuese kërkuese merr për shtetasin e palës së tretë ndonjë leje transitimi të kërkuar, në përputhje me paragrafin (2) të nenit 13.

2. Pala Kontraktuese e kërkuar mund të kërkojë që Pala Kontraktuese kërkuese të sigurojë, përpara largimit të ndonjë shtetasi të palës së tretë nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese, ndonjë leje transitimi e kërkuar nga ligjet ose rregulloret që aplikohen herë pas here në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar përpara transitimit, nëpërmjet territorit të shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar për një shtetas të tillë të palës së tretë.

3. Pala Kontraktuese kërkuese do të ketë përgjegjësi të plotë për transitimin e personave të tillë për në vendin e destinacionit përfundimtar dhe do të jetë përgjegjëse për largimin e atyre personave nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar në rastet kur udhëtimi i mëtejshëm nuk mund të vazhdojë.

4. Pala Kontraktuese e kërkuar mund të kërkojë që një përfaqësues i autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese të sigurojë eskortimin e një transitimi të tillë për shtetasit e Palës së tretë gjatë tranzitimit nëpërmjet territorit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

5. Pavarësisht nga ndonjë autorizim i lëshuar, persona të marrë në ngarkim për qëllime transitimi do të ripranohen nga Pala Kontraktuese kërkuese pa formalitet, nëse rrethanat brenda kuptimit të nenit 21 të kësaj Marrëveshjeje më vonë ngrihen ose dalin në pah, të cilat ndodhin në rrugën e një operacioni transiti ose në rast se udhëtimi i mëtejshëm ose pranimi nga shteti i destinacionit nuk sigurohet më.

6. Palët Kontraktuese do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'iu përmbajtur operacioneve të transitimit për shtetasit e palës së tretë, të cilët nuk mund të kthehen në shtetin e tyre të destinacionit në mënyrë direkte.

Neni 14

Kërkesat për transitim

1. Ndonjë kërkesë për të lejuar transitimin në bazë të nenit 13 të kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe do të përmbajë informacionin i cili është përshkruar në nenin 6 të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesat për të lejuar transitimin do të dërgohen direkt midis autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.

3. Kërkesa do të firmoset dhe vuloset nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese kërkuese.

Neni 15

Përgjigjja për kërkesën

1. Përgjigjja për kërkesën për të lejuar transitimin në bazë të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të Kërkuar për autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditësh-pune nga data e dorëzimit të kërkesës. Çdo refuzim i një kërkesë për të lejuar transitimin do të jetë i argumentuar.

2. Përgjigjja për kërkesën do të përmbajë informacionin i cili është përshkruar në nenin 7 të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Në përputhje me paragrafin (2) të nenit 13, në rastet kur pranohet një kërkesë për të lejuar transitimin, Pala Kontraktuese e kërkuar mund të deklarojë që pranimi nga ana e saj është i kushtëzuar nga leja për të transituar, e cila sigurohet nga shtetasi i palës së tretë përpara largimit nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese me qëllim transitimin nëpërmjet territorit të shtetit të saj.

Neni 16

Refuzimi i kërkesës

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, një kërkesë për transitim në bazë të nenit 13 të kësaj Marrëveshjeje mund të refuzohet kur:

a) prezenca e shtetasit të palës së tretë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar mund të mos jetë në ndihmë të interesave të sigurisë kombëtare, të rendit publik ose të shëndetit publik;

b) shtetasi i palës së tretë nuk ka ndonjë leje për të transituar, leja e cila kërkohet nga Pala Kontraktuese e kërkuar, në përputhje me paragrafin (2) të nenit 13;

c) shtetasi i palës së tretë është refuzuar për t'i dhënë ndonjë leje transitimi, leje e cila kërkohet nga Pala Kontraktuese e kërkuar, në përputhje me paragrafin (2) të nenit 13.

PJESA 4

KLAUZOLAT E PËRGJITHSHME DHE MBYLLËSE

Neni 17

Komiteti i ekspertëve

1. Palët Kontraktuese do t'i sigurojnë njëra-tjetrës asistencë të përbashkët gjatë aplikimit dhe interpretimit të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë ato do të krijojnë një Komitet Ekspertësh, e parashikuar kjo në nenin 12 të protokollit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët Kontraktuese rezervojnë të drejtën të pranojnë ose jo propozimet dhe masat e sugjeruara nga Komiteti i Ekspertëve.

Neni 18

Eskortimi

1. (a) Pala Kontraktuese kërkuese, sa herë të jetë në mënyrë të arsyeshme e praktikueshme, do të informojë Palën Kontraktuese të kërkuar mbi nevojën për të eskortuar persona, për ripranimin ose transitimin e të cilëve është rënë dakord në termat e kësaj Marrëveshjeje.

1. (b) Kur shërbimet e eskortimit sigurohen nga, ose nën drejtimin e, Pala Kontraktuese kërkuese, oficerëve të eskortës do t'u kërkohet që të kenë ndonjë autorizim, vizë ose leje për të

transituar e kërkuar nga Pala Kontraktuese e kërkuar, me qëllim që të kryhen shërbime të tilla eskortimi, përpara largimit nga territori i Palës Kontraktuese kërkuese.

2. Kur transitimi kryhet nëpërmjet transferimit me aeroport në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar ose nëpërmjet pikave të hyrjes për në territorin e saj, masa eskortimi do të merren në rastet kur është e përshtatshme, nga Pala Kontraktuese kërkuese, dhe Pala Kontraktuese e kërkuar do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar se personi i cili do të transitohet nuk do të lejohet të largohet nga zona e transitit të aeroportit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Kur kryhen rastet e largimit për qëllime riparimi ose transitimi, masat e eskortimit do të merren kur është e përshtatshme nga Pala Kontraktuese kërkuese.

Neni 19

Shpenzimet e kthimit

1. Shpenzimet në lidhje me riparimin e personave, përfshirë ato të eskortimit, jetesës dhe transportimit të përshtatshëm, në përputhje me nenet 2, 7 dhe 8 të kësaj Marrëveshjeje, do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuese.

2. Shpenzimet e transitimit, në përputhje me nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje, deri në kufirin e shtetit të destinacionit, dhe në rastet kur është e nevojshme, shpenzimet që rrjedhin nga transporti i kthimit, në të dyja rastet, përfshirë shpenzimet e eskortimit, jetesës dhe të transportimit, do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuese.

Neni 20

Njoftimi

Përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me:

a) pikat e kontrollit të kufirit të cilat mund të përdoren për qëllime riparimi dhe vendet e transitit;

b) autoritetet kompetente për t'u marrë me kërkesat për riparim dhe transitim në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Marrëveshje të tjera që nuk preken dhe përjashtime

1) Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të prekin të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga:

a) marrëveshjet e tjera ndërkombëtare mbi ekstradimin, transferimin e personave të dënuar, asistencën e përbashkët ligjore në çështjet kriminale dhe riparimin ose aktin e transitimit në rastet e largimit të personave në përgjithësi;

b) Konventa në lidhje me Statusin e Refugjatit, bërë në Gjenevë, më 28 korrik 1951, sikurse është amenduar nga protokollin bërë në Nju-Jork më 31 janar 1967;

c) ndonjë marrëveshje ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut;

d) marrëveshjet ndërkombëtare mbi azilin, në veçanti konventa e cila përcakton shtetin përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për azil, paraqitur në një nga shtetet anëtare të Komunitetit Europian, bërë në Dublin, më 15 qershor 1990;

e) ndonjë marrëveshje tjetër ndërkombëtare.

2) Në lidhje me:

a) një person për të cilin Pala Kontraktuese ka detyrim ta ripanojë, në bazë të paragrafit (1) të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) një shtetas të palës së tretë, i cili ka hyrë direkt nga territori i shtetit të njëjës prej Palëve Kontraktuese në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese (dhe një person do të konsiderohet sikur ka hyrë direkt në rast se ai ka transituar nëpërmjet një shteti të palës së tretë për qëllim të hyrjes në Palën tjetër Kontraktuese pa u larguar nga ndonjë zonë transiti të portit ose aeroportit dhe

pa kaluar nëpërmjet pikës së kontrollit të imigracionit);

Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të veprojnë në mënyrë që të paragjykojnë rregullime të tjera të cilat aplikohen herë pas here në territorin e Palës Kontraktuese, me anë të të cilave një person mund të dëbohet ose përndryshe largohet nga territori i njëjës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 22

Modalitetet e zbatimit

Të gjitha klauzolat e mëtejshme për zbatimin janë përcaktuar në protokollin e kësaj Marrëveshjeje, e cila është një pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 23

Aplikimi territorial

1. Kjo Marrëveshje do të aplikohet:

a) në Republikën e Shqipërisë

b) në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar:

i) në Angli dhe Uells, Skoci dhe Irlandën e Veriut; dhe

ii) në çdo territor, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjëse Mbretëria e Bashkuar dhe të të cilat do të ketë qenë shtrirë kjo Marrëveshje, subjekt i ndryshimeve për të cilat është rënë dakord për çdo ndryshim, me marrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese. Një shtrirje e tillë mund të përfundohet nga secila Palë Kontraktuese duke i paraqitur një njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara, Palës tjetër Kontraktuese, nëpërmjet kanalit diplomatik.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Secila Palë Kontraktuese do të njoftojë tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për kompletimin e procedurave të brendshme ligjore të sanksionuara në legjislacionin e saj për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas datës të marrjes së njoftimit të tillë të fundit.

Neni 25

Kohëzgjatja, modifikimi, pezullimi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje ka një vlefshmëri kohore të pacaktuar.

2. Secila Palë Kontraktuese mund ta pezullojë këtë Marrëveshje për arsye të rëndësishme duke i dhënë tjetrës një njoftim me shkrim. Një përfundim i tillë do të ketë efekt në ditën e tridhjetë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese ose në ndonjë datë të mëvonshme të specifikuar në njoftim.

3. Secila Palë Kontraktuese mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke i dhënë tjetrës një njoftim me shkrim mbi baza të rëndësishme. Një pezullim i tillë do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese ose në ndonjë datë tjetër të mëvonshme të specifikuar në njoftim. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën për anulimin e ndonjë njoftimi të tillë pa asnjë vonesë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

4. Amendamentet ose modifikimet e kësaj Marrëveshjeje të rëna dakord nga Palët Kontraktuese do të hyjnë në fuqi kur konfirmohen nëpërmjet shkëmbimit të njoftimeve.

Të poshtëshënuarit duke qenë dëshmitarë dhe duke pasur autorizimin e duhur nga qeveritë e tyre respektive, firmosën këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje, në Tiranë më 14.10.2003, në gjuhën shqipe dhe atë angleze, të dyja tekstet të barasvlefshme.

Në rast mospërputhesh midis teksteve në shqip e anglisht, teksti anglisht do të jetë teksti autentik.

LIGJ
Nr. 9351, datë 3.3.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MISIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË, NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME PËR VETËQEVERISJE NË KOSOVË, PËR SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN, PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në emër të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, për parandalimin e evazionit fiskal”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4506, datë 17.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MISIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME PËR VETËQEVERISJE NË KOSOVË, PËR SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në emër të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë (në vijim do t’u referohemi si “Palët”),

duke dëshiruar, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike, të përfundojnë një marrëveshje për shmangien e tatimeve të dyfishta, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Personat mbi të cilët zbatohet Marrëveshja

Kjo Marrëveshja do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të territorit të njëjës ose e të dyja Palëve.

Neni 2

Tatimet që mbulon Marrëveshja

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që vendosen në emër të një Pale ose autoriteteve të saj lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga shitblerja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave dhe rrogave, si dhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja në veçanti janë:

a) Në Kosovë:

i) Tatimi mbi fitimin;

ii) Tatimi i paragjykuar;

iii) Tatimi mbi të ardhurat personale;

iv) Tatimi mbi pronën;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet kosovare").

b) Në Shqipëri:

i) tatimi mbi fitimin;

ii) tatimi i thjeshtuar mbi fitimin;

iii) tatimi mbi të ardhurat personale;

iv) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet shqiptare").

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëjlojta ose esencialisht të ngjashme, të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Palëve do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor që është bërë në legjislacionin e tyre tatimor.

Neni 3

Përcaktime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përdorja përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termi "Kosova" nënkupton territorin nën administrimin e përkohshëm të UNMIK-ut, siç përcaktohet në rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999;

b) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, kur përdoret në kuptimin gjeografik nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, mbi të cilën, në bazë të ligjeve të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me tabanin detar, nëntokën dhe burimet natyrore të tyre;

c) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

d) termi "kompani" (shoqëri) nënkupton çdo organizatë biznesi ose çdo ent tjetër që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

e) termat "ndërmarrje e territorit të një Pale" dhe "ndërmarrje e territorit të Palës tjetër": nënkuptojnë respektivisht një ndërmarrje të ushtruar nga një rezident i territorit të një Pale dhe një ndërmarrje të ushtruar nga një rezident i territorit të Palës tjetër;

f) termi "tatim" nënkupton tatimin kosovar ose tatimin shqiptar, siç e kërkon përmbajtja;

g) termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije, varkë, avion apo mjet të transportit rrugor që operohet nga një ndërmarrje që ka vendin e drejtimit efektiv në territorin e një Pale, përveç kur anija, varka, avioni ose mjeti i transportit rrugor, vepron vetëm midis vendeve të ndodhura në territorin e Palës tjetër;

h) term, "autoritet kompetent" nënkupton:

i) në Kosovë, Ministrin e Financave dhe të Ekonomisë ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij, në koordinim me UNMIK-un;

ii) në Shqipëri, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2. Përsa i përket zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë nga një Palë, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të asaj Pale, lidhur me tatimet mbi të cilat zbatohet kjo Marrëveshje. Çdo kuptim në bazë të ligjeve tatimore të asaj Pale ka përparësi ndaj kuptimeve të tjera që mund t'i jepen termit nga ligje të tjera të asaj Pale.

Neni 4 **Rezidenti**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i territorit të një Pale” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të aplikueshme në territorin e asaj Pale, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme. Ky term, sidoqoftë, nuk përfshin cilindo person që është subjekt i tatimeve në bazë të ligjeve të aplikueshme në territorin e asaj Pale në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në territorin e kësaj Pale ose kapitalit që ndodhet aty.

2. Kur, për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i territoreve të të dyja Palëve, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) Ai do të konsiderohet rezident i territorit të Palës në territorin e së cilës ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në territoret e të dyja Palëve, ai do të konsiderohet rezident vetëm i territorit të Palës me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);

b) Në qoftë se territori në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet, ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në territorin e asnjërës prej Palëve, ai do të konsiderohet rezident vetëm i territorit të Palës ku qëndron zakonisht;

c) Në qoftë se në bazë të nënparagrafëve të mësipërm (a) dhe (b) të këtij neni rezidenca e individit nuk mund të përcaktohet, atëherë autoritetet kompetente të Palëve do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur, për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person jointivid është rezident i territoreve të të dyja Palëve, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i territorit të Palës në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të tij.

Neni 5 **Selia e përhershme**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i një ndërmarrjeje.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) Një vend drejtimi;

b) Një degë;

c) Një zyrë;

d) Një fabrikë;

e) Një punishte;

f) Një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore;

g) Një fermë apo plantacion;

h) Çdo ambient, magazinë apo dyqan i përdorur për shitjen e mallrave dhe shërbimeve.

3. Termi “seli e përhershme” gjithashtu përfshin një shesh ndërtimi, një konstruksion, një projekt montimi ose instalimi apo aktivitete mbikëqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur sheshe, projekte apo aktivitete të tilla vazhdojnë për një periudhë që i kalon nëntë muaj.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) Përdorimin e ambienteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) Mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

c) Mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një ndërmarrje tjetër;

d) Mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacionesh për ndërmarrjen;

e) Mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për ndërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) Mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët (a) deri (e), me kusht që aktiviteti në kompleks i këtij vendi fiks biznesi që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 6 vepron në territorin e një Pale në emër të një ndërmarrjeje të territorit të Palës tjetër, kjo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në territorin e Palës së përmendur në fillim, lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, në qoftë se ky person ka dhe zakonisht ushtron në territorin e Palës së përmendur në fillim një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të ndërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje e territorit të një Pale nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në territorin e Palës tjetër vetëm për faktin se ajo ushtron biznesin në territorin e kësaj Pale tjetër nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm apo çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që këta persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Megjithatë, kur aktivitetet e një ndërmjetësi të tillë kryhen tërësisht ose thuajse tërësisht në emër të asaj ndërmarrjeje, ai nuk do të konsiderohet një agjent me një status të pavarur në kuptimin e këtij paragrafi.

7. Fakti që një shoqëri (kompani) që është rezidente në territorin e një Pale kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri, që është rezidente në territorin e Palës tjetër, ose që ushtron aktivitet në territorin e asaj Pale tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera), nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për ta konsideruar njërën shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i territorit të një Pale nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pylltaria) të vendosura në territorin e Palës tjetër mund të taten nga kjo Palë tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të aplikueshëm në territorin e Palës ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet, varkat, avionët dhe mjetet e transportit rrugor nuk konsiderohen pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen edhe ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të territorit të një Pale do të taten vetëm nga kjo Palë, përveç kur ndërmarrja ushtron aktivitet në territorin e Palës tjetër nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Në qoftë se ndërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e ndërmarrjes mund të taten nga Pala tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një ndërmarrje e territorit të një Pale ushtron biznes në territorin e Palës tjetër, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë secila Palë do t'i atribuojë selisë së përhershme fitimet që ajo do të realizonte sikur të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e pavarur, që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme, në kushte të njëjta ose të ngjashme, tërësisht e pavarur nga ndërmarrja, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të kryera si në territorin e Palës ku ndodhet selia e përhershme ashtu edhe gjatë.

4. Përderisa për përcaktimin e fitimeve që do t'i atribuohen një selie të përhershme në territorin e një Pale është përdorur metoda e ndarjes së fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesët e saj të ndryshme, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Palë për përcaktimin e fitimeve që do të taten me një metodë të tillë, siç mund të jetë vepruar zakonisht, megjithatë, metoda e ndarjes e adoptuar duhet të jetë e tillë që rezultati të përputhet me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk mund t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se kjo seli e përhershme blen mallra për ndërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë vit pas viti, përderisa të mos ketë arsye të forta për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ujor, rrugor dhe ajror

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve, varkave, avionëve apo mjeteve të transportit rrugor në trafikun ndërkombëtar do të taten vetëm në territorin e Palës ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Nëse vendi i drejtimit efektiv i një ndërmarrjeje transportuese ndodhet në bordin e një anijeje ose varke, atëherë ajo do të konsiderohet e vendosur në territorin e Palës në të cilin ndodhet porti i qëndrimit të zakonshëm të anijes ose, nëse nuk ka një port të tillë, në territorin e Palës, rezident i së cilës është operuesi i anijes ose i varkës.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen, gjithashtu, ndaj fitimeve të realizuara nga pjesëmarrja në një bashkësi, një biznes të përbashkët apo në një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9

Ndërmarrje të lidhura

1. Kur

a) një ndërmarrje e territorit të një pale merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të territorit të Palës tjetër, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të territorit të një Pale dhe të një ndërmarrjeje të territorit të Palës tjetër,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar midis dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra ndërmarrje, por që për shkak të lidhjeve të veçanta të përmendura në fillim nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatonet normalisht.

2. Kur një Palë përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të territorit të asaj Pale dhe i taton ato normalisht, fitimet për të cilat një ndërmarrje e territorit të Palës tjetër është rënduar me tatim nga Pala tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga ndërmarrja e territorit të Palës së përmendur në fillim, nëse kushtet e krijuara midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë ajo Palë tjetër do të bëjë një rregullim në masën e duhur të shumës së tatimit të vendosur prej saj mbi këto fitime. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla duhet t'i kushtohet vëmendje edhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Palëve do të konsultojnë njëra-tjetrën, nëse është e nevojshme.

Neni 10 **Dividendët**

1. Dividendët e paguar nga një kompani që është rezidente e territorit të një Pale një rezident të territorit të Palës tjetër mund të tatonen nga kjo Palë tjetër.

2. Megjithatë, të tillë dividendë mund të tatonen gjithashtu nga Pala në territorin e së cilës është rezidente kompania paguese e dividendëve dhe në përputhje me ligjet e aplikueshme në territorin e kësaj Pale, por nëse pronari përfitues i dividendëve është një rezident i territorit të Palës tjetër, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 për qind të shumës bruto të dividendëve. Autoritetet kompetente të Palëve do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi. Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të kenë efekt mbi tatimin e kompanisë, lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Në funksion të këtij neni, termi “dividendë” nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si edhe të ardhurat nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Palës në territorin e së cilës është rezidente kompania që bën shpërndarjen e dividendëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i territorit të një Pale, ushtron aktivitet në territorin e Palës tjetër, rezidente në territorin e së cilës është kompania paguese e dividendëve individëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në territorin e asaj Pale tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Kur një kompani që është rezidente e territorit të një Pale realizon fitime ose të ardhura nga territori i Palës tjetër, kjo Palë mund të mos zbatojë tatimin mbi dividendët e paguar nga kompania, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të territorit të Palës tjetër ose kur zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose një bazë fikse të vendosur në territorin e kësaj Pale tjetër; subjekt i tatimit mbi fitimet e pa shpërndara nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe sikur dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në territorin e kësaj pale tjetër.

Neni 11 **Interesat**

1. Interesat që krijohen në territorin e një Pale dhe i paguhen një rezidenti të territorit të Palës tjetër mund të tatonen nga kjo Palë tjetër.

2. Megjithatë këto interesa mund të taten edhe nga Pala në territorin e së cilës ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e aplikueshme në territorin e kësaj Pale, por kur pronari përfitues i interesave është një rezident i territorit të Palës tjetër, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të palëve do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “interesa” në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim ndaj pasurive, dhe që kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti të ardhurat nga bonot e thesarit dhe obligacionet, përfshirë çmimet dhe shpërblimet që i shtohen këtyre bonove dhe obligacioneve. Gjybat për pagesë të vonuar nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të zbatohen, në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë një rezident i territorit të një Pale, ushtron biznes në territorin e Palës tjetër ku krijohen interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen shërbime personale të pavaruara nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe kërkesat e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Interesa do të konsiderohen se krijohen në territorin e një Pale ku pagues është vetëm ajo Palë, një ndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i territorit të asaj Pale. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i territorit të një Palë, ka në territorin e një Palë një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi, dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në territorin e Palës ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose midis të dyve dhe personave të tretë, shumica e interesave, bazuar në huanë për të cilën ato paguhet, e kalon shumën mbi të cilën duhet të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmenduar në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e aplikueshme në territorin e secilës Palë, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Të ardhurat nga drejta e shfrytëzimit të pronësisë intelektuale (honoraret)

1. Honoraret që krijohen në territorin e një Pale dhe i paguhet një rezidenti të Palës tjetër mund të taten nga kjo Palë tjetër.

2. Megjithatë, këto të ardhura mund të taten gjithashtu nga Pala në territorin e së cilës krijohen dhe në përputhje me ligjin e aplikueshëm në territorin e kësaj Pale, por nëse pronari përfitues i honorareve është një rezident i territorit të Palës tjetër, tatimi i vendosur nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorarit. Autoritetet kompetente të palëve do të vendosin me mirëkuptim reciprok për mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “honorare” nën dispozitat e këtij neni nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe regjistrimet për transmetime në radio ose televizion, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, ose për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i territorit të një Pale, ushtron biznes në territorin e Palës tjetër ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhet honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Honoraret do të konsiderohet se krijohen në territorin e një Pale kur pagues është vetë ajo Palë, një nëndarje politike, një autoritetet lokal ose një rezident i territorit të asaj Pale. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i territorit të një Pale, ka në territorin e një Palë një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve, dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare do të konsiderohen se kanë lindur në territorin e Palës ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal mbetet e tatueshme sipas ligjeve të aplikueshme në territorin e secilës Palë, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet nga tjetërsimi i kapitalit

1. "Fitimet e realizuara nga një rezident i territorit të një Pale nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në territorin e Palës tjetër mund të taten nga kjo Palë tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë e biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e territorit të një Pale ka në territorin e Palës tjetër ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse, që një rezident i territorit të një Pale ka në territorin e Palës tjetër për të kryer shërbime personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me ndërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të taten nga kjo Palë tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve, varkave, avionëve ose mjeteve të transportit rrugor që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve, varkave, avionëve apo mjeteve të transportit rrugor do të taten vetëm nga Pala, në territorin e së cilës ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet e realizuara nga një rezident i territorit të një Pale nga tjetërsimi i aksioneve, vlera e të cilave rrjedh direkt ose indirekt më tepër se 50 për qind nga pasuri të paluajtshme të ndodhura në territorin e Palës tjetër, mund të taten nga kjo Palë tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, mund të taten nga Pala, në territorin e së cilës është resident përfituesi.

Neni 14

Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ, i cili është rezident i territorit Palë lidhur me shërbime profesionale ose aktivitete të tjera të një karkateri të pavarur, do të taten vetëm nga ajo Palë, përveç në rrethanat që vijojnë, kur të ardhura të tilla mund të taten gjithashtu edhe nga Pala tjetër:

a) Nëse ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në territorin e Palës tjetër që rregullisht i shërben atij për të kryer aktivitetet e tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohen kësaj baze fikse mund të taten nga kjo Palë tjetër; ose

b) Nëse qëndrimi i tij në territorin e Palës tjetër është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave të realizuara nga aktivitetet e tij të kryera në territorin e kësaj Pale tjetër mund të taten nga kjo Palë tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mësimdhënieje, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe kontabilistëve.

Neni 15
**Shërbimet personale të varura
(të ardhurat nga punësimi)**

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16,18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i territorit të një Pale nga punësimi i tij do të taten vetëm nga kjo Palë përveç kur puna është ushtruar në territorin e Palës tjetër. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të taten nga kjo Palë tjetër.

2. Përjashtuar dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i territorit të një Pale lidhur me punën, e ushtruar në territorin e Palës tjetër do të taten vetëm nga Pala e përmendur në fillim, në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Përfituesi (marrësi) është prezent në territorin e Palës tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë gjatë një periudhe 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) Shpërblimi paguhet nga, ose në emër të, një punëdhënësi që nuk është rezident i territorit të Palës tjetër;

c) Shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në territorin e Palës tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, shpërblimet e realizuar nga një rezident i një Pale, lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anijeje, varke, avioni ose mjete të transportit rrugor që vepron në trafikun ndërkombëtar, mund të taten nga Pala në territorin e së cilës ndodhet qendra efektive e drejtimit të ndërmarrjes.

Neni 16
Shpërblimet e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i territorit të një Pale në pozitën e tij si anëtar i Këshillit të Drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e territorit të Palës tjetër, mund të taten nga kjo palë tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i territorit të një Pale si një artist, si aktor teatri, kinematografie, radio-televizioni, muzikant, apo si sportist, nga aktiviteti i tij personal si i tillë, i ushtruar në territorin e Palës tjetër, mund të taten nga kjo Palë tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga sportisti apo artisti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të taten nga Pala në territorin e së cilës janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

Neni 18
Pensionet

Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme që i paguhen një rezidenti të territorit të një Palë, lidhur me punësimin e tij në të kaluarën, do të taten vetëm nga kjo Palë.

Neni 19
Shërbimet qeveritare

1. a) Pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Palë apo nga një autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet që ai i ka kryer asaj Pale apo autoriteti lokal do të taten vetëm nga ajo Palë.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të taten vetëm nga Pala tjetër, nëse shërbimet janë kryer në territorin e asaj Pale dhe individ është rezident i asaj Pale.

2. a) Çdo pension i paguar nga, apo prej fondeve të krijuara, prej një Pale ose nga një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera asaj Pale ose autoriteti lokale do të taten vetëm nga ajo Palë.

b) Megjithatë, këto pensione do të taten vetëm nga Pala tjetër nëse individ është rezident i territorit të asaj Pale.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen mbi pagat, shpërblime të tjera të ngjashme dhe pensionet për shërbimet e kryera lidhur me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Palë apo autoritet lokal atje.

Neni 20
Studentët, specializantët, pedagogët dhe kërkuesit shkencorë

1. Një rezident i territorit të një Pale që është përkohësisht prezent në territorin e Palës tjetër si një student në një universitet, kolegji apo shkollë, ose si një specializant, nuk do të taten nga kjo Palë tjetër për çdo pagesë apo shpërblim të marrë për të përbulluar jetesën, arsimin apo trajnimin, me kusht që pagesa apo shpërblime të tilla të rrjedhin nga burime jashtë territorit të kësaj Pale tjetër.

2. Pagesat ose shpërblimet që studentët ose specializantët, rezidentë të territorit të një Palë, marrin nga punësimi i përkohshëm në territorin e Palës tjetër ku ata ndodhen për qëllime studimi apo trajnimi, do të gëzojnë të njëjtin trajtim tatimor si studentët ose specializantët që janë rezidentë të territorit të kësaj Pale tjetër.

3. Pagesat ose shpërblimet e marra nga një rezident i territorit të një Pale i cili është prezent në territorin e Palës tjetër me detyrën e një pedagogu ose kërkuesi shkencor në një universitet apo institucion tjetër shkencor, për një periudhë që nuk i kalon dy vite kalendarike, nuk do të taten nga kjo Palë tjetër, me kusht që këto pagesa apo shpërblime rrjedhin nga burime jashtë territorit të kësaj Pale tjetër.

4. Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga kërkimet shkencore, të cilat nuk kryhen për interesat publike, por kryesisht për interesa të një personi apo personave të veçantë.

Neni 21
Të ardhura të tjera

1. Lloje të të ardhurave të një rezidenti të territorit të një Pale, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me nenet e mëparshme të kësaj Marrëveshjeje do të taten vetëm nga ajo Palë.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i territorit të një Pale, ushtron biznes në territorin e Palës tjetër nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen atje shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14, si të paraqitet rasti.

Neni 22
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që i referohen nenit 6, të zotëruara nga një rezident i territorit të një Pale dhe të vendosura në territorin e Palës tjetër, mund të taten nga kjo Palë tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e territorit të një pale ka në territorin e Palës tjetër ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të territorit të një Pale në territorin e Palës tjetër për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të taten nga kjo Palë tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije, varka, avionë dhe mjete të transportit rrugor që veprojnë në trafikun ndërkombëtar, si dhe pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve, varkave, avionëve dhe mjeteve të transportit rrugor, do të taten vetëm në territorin e Palës në të cilën ndodhet qendra e drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjithë elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të territorit të një Pale do të taten vetëm në territorin e kësaj Pale.

Neni 23
Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Kur një rezident i territorit të një pale realizon të ardhura ose zotëron kapitale, të cilat në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të taten nga Pala tjetër, Pala e përmendur në fillim do të lejojë:

i) Një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguara në këtë Palë tjetër, dhe

ii) një reduktim nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti të një shume të barabatë me tatimin mbi kapitalin e paguar në këtë Palë tjetër.

Megjithatë, një reduktim i tillë, në asnjë rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose mbi kapitalin, siç është llogaritur më parë, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit, që mund të taten në Palën tjetër.

2. Kur në përputhje me çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i territorit të një pale përjashtohet nga tatimi në territorin e kësaj pale, megjithatë kjo Palë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi pjesën e mbetur të të ardhurave ose të kapitalit të këtij rezidenti, mund të marrë në konsideratë të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 24
Mosdiskriminimi

1. Rezidentët e territorit të një Pale nuk do të jenë, në territorin e Palës tjetër, subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen rezidentët e territorit kësaj Pale tjetër në rrethana të njëjta.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një ndërmarrje e territorit të një pale ka në territorin e Palës tjetër nuk do të jetë më pak i favorshëm në territorin e kësaj Pale tjetër sesa tatimi i vendosur ndaj ndërmarrjeve të territorit të kësaj Pale tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyrim i një Pale për t'i garantuar rezidentëve të territorit të Palës tjetër çfarëdo lehtësish apo reduktimesh personale për qëllime tatimore për shkak të gjendjes civile apo përgjegjësisë familjare të cilat i garanton rezidentëve të territorit të vet.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafi 6 të nenit 11, ose paragrafi 6 të nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e territorit të një pale një rezidenti të territorit të Palës tjetër, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kondita njëlloj

sikur ato t'i pagueshin një rezidenti të territorit të palës së përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një ndërmarrjeje të territorit të një Pale ndaj një rezidenti të territorit të Palës tjetër, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kondita njëloj sikur ajo të kishte me një rezident të territorit të palës të përmendur në fillim.

4. Ndërmarrjet e territorit të një pale, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt nga një ose më shumë rezidentë të territorit të Palës tjetër, nuk do të jenë në territorin e Palës së përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndësishëm sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të territorit të Palës së përmendur në fillim.

5. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, dispozitat e këtij neni do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji.

Neni 25

Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njëres apo e të dy autoriteteve kompetente të Palëve rezultojnë apo do të rezultojnë me tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në ligjet e aplikueshme në territoret e Palëve, ai mund t'ia paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Palës rezident i së cilës ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vet nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet t'a zgjidhë me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Palës tjetër, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga limitet kohore të përcaktuara nga ligjet e aplikueshme në territoret e Palëve.

3. Autoritetet kompetente të Palëve do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Marrëveshjes. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë për rastet që nuk parashikohen në këtë Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të Palëve mund të komunikojë me njëri-tjetrin direkt, edhe nëpërmjet një komisioni të përbashkët të përbërë prej tyre apo përfaqësuesve të tyre, me qëllim arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm të këtij neni.

Neni 26

Shërbimi i informacioneve

1. Autoritetet kompetente të Palëve do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose të ligjeve të aplikueshme në territoret e Palëve lidhur me tatimet që mbulon marrëveshja, përderisa taksimi nuk është në kundërshtim me Marrëveshjen, sidomos për parandalimin e mashtrimeve apo evazionit në këto tatime. Shkëmbimi i informacioneve nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2. Çdo informacion i marrë nga autoriteti kompetent do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën ligjin e aplikueshëm në territorin e asaj Pale në të cilën është i vendosur ky autoritet kompetent. Megjithatë, nëse informacioni konsiderohet si sekret nga autoriteti kompetent që e transmeton informacionin, ai do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në vlerësimin apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Marrëveshja. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime dhe mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk mund të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njëri prej Palëve detyrimin:

a) Të zbatojë masa administrative të ndryshme nga ato që parashikohen me ligjet dhe praktikatat administrative në territorin e asaj pale apo të palës tjetër;

b) Të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve apo praktikës normale administrative të asaj Pale apo të palës tjetër;

c) Të japë informacione që mund të nxirrnin një sekret tregtar, biznesor, industrial apo profesional ose proces tregtar apo informacione, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

Neni 27

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe konsullore

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë privilegjet fiskale të anëtarëve të zyrave ndërlidhëse të qeverive të huaja, misioneve diplomatike apo konsullore në territorin e një pale, që rrjedhin nga ligji i aplikueshëm, rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të Marrëveshjeve të veçanta, kjo Marrëveshje po ashtu nuk do të cenojë statusin, privilegjet dhe imunitetet e UNMIK-ut dhe KFOR-it.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet të cilit Palët do të informojnë njëri-tjerin se procedurat e tyre të brendshme ligjore janë përfunduar, dhe dispozitat e saj do të kenë efekt nga 1 janari i vitit që pason atë të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, dhe nuk do të ketë fuqi prapavepruese (retroaktive).

Neni 29

Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e saj nga njëra Palë. Secila Palë mund të përfundojë Marrëveshjen duke dhënë njoftimin e përfundimit me shkrim të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik pas vitit 2010. Në rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas 1 janarit të vitit që pason atë të dhënies së njoftimit të përfundimit.

Në praninë e duhur, përfaqësuesit e autorizuar të palëve kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Prishtinë, më 28 shtator 2004, në gjuhët shqipe, angleze dhe serbe, të gjitha autentikisht të barabarta. Në raste divergjencash midis teksteve, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Sigluar nga:

Ali Sadriu, Ministër i Financave dhe Ekonomisë,
institucionet e përkohshme për
vetëqeverisje në Kosovë
28.4.2004

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ministri i Financave
Arben Malaj

PËR MISIONIN E PËRKOZHSHËM ADMINISTRATIV
TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË NË
EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOZHSHME PËR
VETQEVERISJE
Soren Jessen Petersen
PËRFAQËSUES SPECIAL I SEKRETARIATIT TË
PËRGJITHSHËM

LIGJ
Nr. 9352, datë 3.3.2005

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8102, DATË 28.3.1996 "PËR
KUADRIN RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË
LARGIMIT DHE PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, fjala "lokale" zëvendësohet me fjalën "vendore".

Neni 2

Në nenin 10 shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) tarifat e caktuara nga Enti Rregullator, të detyrueshme për të licencuarit, për efekt të verifikimit të zbatueshmërisë së dokumenteve standarde të strukturës së tarifës së shërbimit, si dhe tarifa të tjera për licenca të dhëna nga Komisioni."

Neni 3

Shkronjat "b", "c" dhe "f" të nenit 14 ndryshohen si më poshtë:

"b) të miratohet çmimet apo tarifat dhe afatet ose kushtet e shërbimit të kryer nga të licencuarit ose, kur është e përshtatshme, nga entet e palicensuara, që sigurojnë ujë për konsum publik, në rastet kur sistemet e ujësjellës-kanalizimeve nuk kanë kaluar në administrim ose pronësi të njësive të qeverisjes vendore;

c) të caktojë procedurat dhe standardet për programet e investimeve dhe për shitjen e asetëve nga të licencuarit në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve, në rastet kur ato nuk kanë kaluar në administrim ose pronësi të njësive të qeverisjes vendore;

f) në bashkërendim me njësitet e qeverisjes vendore, të përgatisë raporte për Qeverinë për gjendjen e sektorit dhe të grumbullojë të dhënat përkatëse nga të licencuarit;"

Neni 4

Pika 1 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

"1. Personat fizikë apo juridikë të palicensuar ose njësitet e qeverisjes vendore, që nuk kanë në pronësi sisteme të ujësjellës-kanalizimeve, nuk mund të merren me veprimtarinë e grumbullimit, shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit për përfitim publik."

Neni 5

Pika 1 e nenit 21 ndryshohet si më poshtë:

"1. Enti Rregullator, nëpërmjet kuadrit të plotë të rregullave të miratuara, përcakton procedurat dhe standardet minimale kombëtare, në bazën e të cilave njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të përcaktojnë, të miratojnë, të ndryshojnë apo të mos miratojnë çmimet a tarifafat, afatet dhe kushtet e shërbimit për të gjitha shitjet e ujit apo shërbimet e kryera nga i licencuari, sipas këtij ligji."

Neni 6

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 22

Procedurat për vendosjen e tarifave

1. Enti Rregullator të përcaktojë metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave të shitjes, me shumicë e pakicë, të ujit dhe të standardeve nga njësitë e qeverisjes vendore, që kanë në pronësi sistemet e ujësjellës-kanalizimeve.

2. Njësitë e qeverisjes vendore të vendosin tarifafat, me shumicë dhe pakicë, në bazë të metodologjisë së përlllogaritjes së tarifave, të miratuara nga Enti Rregullator.

3. Asnjë tarifë apo pjesë e saj nuk mund të ndryshohet më shumë se një herë në vit."

Neni 7

Pas pikës 4 të nenit 23 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Njësitë e qeverisjes vendore, pronare të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, janë të detyruara që brenda 10 ditëve nga marrja e vendimeve të tyre në fushën e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, të njoftojnë Entin Rregullator, duke paraqitur dokumentacionin e plotë për marrjen e vendimit, sipas përcaktimit të bërë në metodologjinë për caktimin e tarifave.

Enti Rregullator, kur vëren se vendimi i këshillit të bashkisë/komunës është i papajtueshëm me metodologjinë e caktimit të tarifave dhe me standardet e shërbimit, ka të drejtë ta kthejë vendimin, të shoqëruar me vërejtje të argumentuara, për rishqyrtim në këshillin përkatës. Nëse vërehen papajtueshmëri edhe në aktin e rishqyrtuar, Enti Rregullator i drejtohet gjykatës, nën juridiksionin e së cilës është organi i qeverisjes vendore, duke kërkuar pavlefshmërinë e këtij akti.

Enti Rregullator ka të drejtë ta kthejë vetëm një herë vendimin e këshillit përkatës për rishqyrtim.

Në rast se Enti Rregullator nuk kthen përgjigje brenda 20 ditëve nga data e njoftimit, vendimi vlerësohet i miratuar."

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4507, datë 17.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr. 9353, datë 3.3.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8096, DATË 21.3.1996
"PËR KINEMATOGRAFINË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

"Autor", në kuptim të këtij ligji, është personi fizik ose personat fizikë që, në sajë të aftësive të veta krijuese, krijojnë një veprë artistike, kinematografike. Autorët e përfshirë, kriteret e vlerësimit të autorëve dhe të elementeve estetike përcaktohen në ligjin "Për të drejtën e autorit".

"Producent i një veprë filmike" është një person ose grup personash fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që organizon e mbështet ekonomikisht dhe merr përgjegjësinë për realizimin e veprës filmike me ose pa fond buxhetor. Ai gëzon të drejtën e shfrytëzimit ekonomik mbi veprën filmike të realizuar. Këtu përjashtohen personat juridikë publikë, të cilët nuk ndjekin qëllim fitimprurës.

"Distributor" është personi fizik ose juridik apo një grup personash fizikë a juridikë, apo një ndërthurje e tyre, vendas ose të huaj, që realizon, për qëllime përfitimi ekonomik, tregtimin ose shpërndarjen e veprës filmike.

"Shtëpi kinematografike" janë producentët që kryejnë veprimtari në fushën e prodhimit kinematografik, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Shtëpitë kinematografike veprojnë si persona juridikë dhe janë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë (QKK).

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) vepron si person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për bashkërendimin e punës, mbështetjen financiare, nxitjen e veprimtarisë kinematografike në Republikën e Shqipërisë dhe për përfaqësimin e kinematografisë shqiptare në botë.

Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Rregullorja e funksionimit të QKK-së miratohet nga Kryetari i kësaj Qendre."

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pikat 5, 6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

"5. Propozon ndryshime dhe përmirësime në ligje, vendime, urdhra e urdhëresa të fushës dhe, veçanërisht, për masat organizative, teknike, ligjore dhe financiare, për një funksionim më të mirë të sistemit ligjor kombëtar të filmit, të cilat, pasi shqyrtohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave nëpërmjet Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

6. Organizon dhe mbështet financiarisht kualifikimin, specializimin dhe përgatitjen e kineastëve të rinj, si dhe botimet e ndryshme të veprimtarisë kinematografike.

7. Regjistron të gjithë personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe të shpërndarjes së filmave, sipas procedurave të përcaktuara në rregullore, si dhe pajis me certifikatë për ushtrimin e këtyre veprimtarive të gjithë aplikantët, që plotësojnë kushtet e nevojshme, të përcaktuara në rregullore."

- Pas pikës 12, shtohen pikat 13, 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

"13. Shqyrton, nga ana artistike, projektet e paraqitura nga relatorët e caktuar në këshillin e projekteve.

14. Analizon dokumentacionin tekniko-ekonomik të projekteve të paraqitura, duke zbatuar normativat e miratuara prej saj.

15. Mbështet financiarisht, me një fond të veçantë buxhetor, projektet e shpërndarjes së veprave filmike shqiptare, brenda dhe jashtë vendit."

Neni 4

Në fund të nenit 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Përdorimi i fondit buxhetor për financimin e prodhimit të veprës filmike përjashton procedurat e ligjit "Për prokurimin publik" dhe zbaton dispozitat e këtij ligji dhe të akteve në zbatim të tij."

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8

Këshillat miratues të projekteve propozohen dhe zgjidhen nga shoqatat e kineastëve.

Këshillat miratues të projekteve drejtohen nga kryetarët e tyre, të cilët zgjidhen prej këshillave përkatës.

Këshillat miratues të projekteve janë organizma të përkohshëm dhe jofunksionalë.

Këshillat miratues të projekteve kanë afat 2-vjeçar.

Këshilli miratues i projekteve për veprimtarinë kinematografike përbëhet nga 5-7 persona.

Mënyra e funksionimit të këtyre këshillave përcaktohet në rregulloren e brendshme të QKK-së."

Neni 6

Në nenin 9 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kryetari i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë ka të drejtë të rikthejë vendimin e këshillit miratues të projekteve për përzgjedhjen e një projekti, duke dhënë bashkëlidhur arsyet përkatëse. Në rast se projekti rivlerësohet dhe vendimi rimiratohet nga këshilli, ai hyn në fuqi menjëherë."

Neni 7

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14

Kontrata e prodhuesit me autorët e veprës filmike, me anë të së cilës këta të fundit i kalojnë prodhuesit të drejtën e shfrytëzimit ekonomik të veprës, përbën kusht për përfitimin e financimit të prodhimit të veprës përkatëse me fondet buxhetore të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Prodhuesi detyrohet ta fillojë dhe ta përfundojë prodhimin e veprës filmike, të financuar me ose pa fondin buxhetor të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në afatin e deklaruar.

Dy paragrafët e mësipërm zbatohen edhe për shtëpitë kinematografike."

Neni 8

Në nenin 16, pas paragrafit të dytë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Distributori është i detyruar që të deklarojë në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë të ardhurat, që përfitohen nga tregtimi ose shpërndarja e veprës filmike, të prodhuar me fondin buxhetor të kësaj qendre, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj. Kjo dispozitë është e vlefshme edhe për shtëpitë kinematografike.

Deklarimi i të ardhurave gjatë vitit të parë të shfrytëzimit bëhet çdo tre muaj, gjatë tre viteve pasardhëse deklarimi bëhet çdo gjashtë muaj, ndërsa për pjesën e mbetur deri në fund të 10 viteve, deklarimi bëhet çdo vit."

Neni 9

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23

Vepra filmike, e prodhuar me fondin buxhetor të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, tregtohet ose shpërndahet nga distributori apo nga shtëpia kinematografike, duke respektuar kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

Administrimi i prodhimit kinematografik të Kinostudios "Shqipëria e re" deri në vitin 1990 kalon nga Albafilm Studio te Qendra Kombëtare e Kinematografisë."

Neni 10

Pas neni 39 shtohet neni 39/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 39/1

Nenet 24, 25, 26 të ligjit nr.8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë" shkrihen në një nen të vetëm dhe formulohen si më poshtë:

"Studio Albafilm dhe Studio Albafilm Animacion do të quhen Albafilm dhe në zbatim të këtij ligji Albafilmi është një shoqëri aksionere, ku shteti ruan 100 për qind të aksioneve.

Shoqëria e re Aksionere Albafilm regjistrohet në gjykatë brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për zbatimin e këtij neni."

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4508, datë 17.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

URDHËR
Nr. 108, datë 4.3.2004

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT
TË PESHKIMIT (OMP SHIJAK)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Shijak, që i bashkëngjitet këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË
Agron Duka

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 26.3.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2005

Çmimi: 200 lekë